

SI TË NDIHMOJMË PRINDËRIT PËR T'U KUJDESUR PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN CILËSOR TË FËMIJËVE GJATË FËMIJËRISË SË HERSHME

Manual në ndihmë të prindërve dhe të mësuesve



SI TË NDIHMOJMË PRINDËRIT PËR T'U KUJDESUR PËR ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN CILËSOR TË FËMIJËVE GJATË FËMIJËRISË SË HERSHME

Manual në ndihmë të prindërve dhe të mësuesve



Manuali

Ky manual botohet në kuadër të projektit “Çdo fëmijë rom në kopsht”, një nismë e Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit dhe UNICEF, zbatuar nga: Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (ODF) dhe Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) dhe Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare (YWCA of Albania), financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri dhe Agjensia Austriake për Zhvillim.

Manuali synon t’u vijë në ndihmë të gjithë prindërve të fëmijëve 0-6 vjeç për t’i ndërgjegjësuar dhe aftësuar ata në përdorimin e teknikave të prindërimit pozitiv. Ky botim mund të përdoret, gjithashtu, nga mësueset e arsimit parashkollor si dhe nga koordinatorët lokalë të organizatave që po zbatojnë projektin, gjatë takimeve sensibilizuese me familjet në nevojë.

Manuali u hartua nga specialistët dhe njohësit e fëmijërisë së hershme:

Florian Kulla, psikolog për fëmijët

Aurela Zisi, specialiste e arsimit parashkollor dhe fillor pranë Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA)

si dhe me kontributin e **Ermelinda Ikonomit**.

Koordinimi: **Donika Godaj**

Redaktore letrare: **Kristina Jorgaqi**

ISBN:

Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo të kopjohet lirisht prej mësuesve dhe specialistëve të fëmijërisë së hershme për qëllime mësimore, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e institucioneve të mësipërme si burim.

Pikëpamjet e autorëve të këtij botimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe politikat e UNICEF-it.

Hyrje

Mjedisi i shtëpisë luan një rol thelbësor në përcaktimin e mundësive të fëmijës për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar. Kushti bazë që një fëmijë të rritet shëndetshëm, është mjedisi fizik, në të cilin fëmija ka lodra, objekte dhe libra në përputhje me nivelin e tij të zhvillimit. Një mjedis fizik i rregulluar mirë dhe i sigurtë i jep mundësi fëmijës të luajë, të eksplorojë dhe të zbulojë.

Shumë fëmijë që vijnë nga familje me të ardhura të pakta dhe komunitete në risk, përjetojnë dhunë e u mohohen të drejtat bazë për edukim dhe formim cilësor. Për shkak të rrethanave të vështira, ata nuk shkojnë në kopshte e shkolla si dhe hasin një numër të madh vështirësish emocionale e të sjelljes. Edhe pse shumë prindër përpiqen t'i rrisin me kujdes fëmijët, ndodh që ndonjëherë të ndihen të mbingarkuar ose të mos dinë si të gjejnë rrugën më të mirë përballë sfidave të mëdha.

Ky manual është hartuar për t'u ardhur në ndihmë prindërve, veçanërisht prindërve dhe familjeve në risk. Informacionet e përzgjedhura në manual bazohen në standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç, në idetë më të mira të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme, ide që bazohen në studime dhe praktika të gjata me familjet e fëmijëve parashkollorë. Duke zbatuar informacionin dhe aftësitë e përshkruara në manual, prindërit do të jenë në gjendje të kujdesen më mirë për mirëqenien e fëmijës si dhe të vlerësojnë rëndësinë e ndjekjes së arsimit parashkollor.

Zhvillimi optimal i trurit kërkon që fëmija të ketë së paku një mjedis stimulues, ushqim të shëndetshëm dhe marrëdhënie sociale me persona që janë të vëmendshëm ndaj nevojave të tij. Kushtet jo të sigurta, marrëdhëniet negative dhe mungesa e mundësive për arsimim gjatë viteve të para të jetës, mund të bëjnë që fëmijët të humbasin mundësinë që u ofron kjo periudhë e zhvillimit, çka mund të ketë pasoja të pakthyeshme dhe të prekë potencialin e tyre për të gjithë jetën.

E drejta e fëmijës për zhvillim dhe arsimim është e pranuar kudo në botë si dhe në vendin tonë. Konventa për të Drejtat e Fëmijës thekson rëndësinë e zhvillimit në fëmijërinë e hershme dhe shpreh qartë se çdo fëmijë ka të drejtë të zhvillojë maksimumin e potencialit të vet dhe se çdo vend që ka miratuar këtë konventë, duhet të mbështesë të drejtën e fëmijëve për një standard të pranueshëm jetese për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social të tyre. Ndaj dhe sigurimi i kushteve bazë për zhvillimin emocional, njohës dhe social të fëmijëve duhet të ketë prioritet për të pasur fëmijë sa më të shëndetshëm.



Përmbajtja e manualit

Manuali përbëhet nga 11 kapituj. Secili prej tyre trajton me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për lexuesin aspekte të zhvillimit, të të nxënies, të kujdesit dhe të edukimit të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme.

◆ Kapitulli 1

“Çfarë duhet të dijë prindi për fëmijët në moshën 0 – 6 vjeç” trajton rëndësinë që kanë gjashtë vitet e para të jetës për të gjithë fëmijët. Krijimi i një marrëdhënieje të sigurt me prindin ndikon shumë te fëmijët për të ndierë sigurinë, dashurinë dhe stimulimin e të rriturit. Në këtë kapitull trajtohen faktorët kryesorë që ndikojnë në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës në këto vite, si dhe jepen udhëzime të rëndësishme për prindin, që sjellin rritjen e shëndetshme të fëmijës, pasi mjedisi më i rëndësishëm që ndikon jetën e fëmijës është mjedisi i shtëpisë.

◆ Kapitulli 2

“Cilat janë nevojat bazë të fëmijëve në këtë moshë” trajton nevojat që kanë fëmijët ndaj prindërve, në mënyrë që të ndihen të sigurtë, të rriten të shëndetshëm dhe të gatshëm për të mësuar. Në mënyrë të veçantë përmbajtja e këtij kapitulli përqendrohet te nevojat fizike, emocionale, sociale, psikologjike dhe zhvillimi i aftësive për shkollë.

◆ Kapitulli 3

“Pse prindi është mësuesi i parë i fëmijës” trajton rolin e prindit në zhvillimin dhe mësimin e fëmijës. Në këtë kapitull trajtohen momentet kryesore që kalojnë fëmijët në secilin prej stadeve të zhvillimit të tyre, analizohen fushat e zhvillimit fizik, njohës, gjuhësor, social-personal, si dhe jepen udhëzime sesi prindi mund ta kuptojë fëmijën dhe atë se çfarë përjeton, bën apo si vepron ai.

◆ Kapitulli 4

“Pse mbrojtja fillon në familje” trajton 4 tipet kryesore të keqtrajtimit të fëmijës, shpjegon ku, pse dhe si ndodh abuzimi ndaj tyre, pasojat kryesore të dhunës te fëmijës etj. Kapitulli trajton rëndësinë që ka përfshirja e fëmijëve në vendimet që merren dhe rolin e veçantë të babait në familje. Në këtë kapitull jepen, gjithashtu, këshilla të rëndësishme për prindërit për t'i mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe abuzimi.

◆ Kapitulli 5

“Si duhet të komunikohet me fëmijët e vegjël” thekson rëndësinë e mënyrës së komunikimit të prindit me fëmijën në zhvillimin e gjuhës, krijimin e besimit, të sigurisë, të respektit, të vetëvlerësimit etj. Në këtë kapitull jepen udhëzime për prindin lidhur me atë se çfarë duhet të bëjë dhe çfarë nuk duhet të bëjë ai kur komunikon me fëmijën.

◆ **Kapitulli 6**

“Si duhet të disiplinohen fëmijët e vegjël” e vlerëson disiplinën si procesin e udhëzimit të fëmijës për sjelljet e pranueshme dhe jo të pranueshme. Disiplinimi i fëmijës është detyrë kryesore e prindërve, ndaj është e rëndësishme për çdo prind të ketë disa njohuri bazë mbi disiplinimin e tyre. Një vend të veçantë zë në kapitull shpjegimi i dallimit ndërmjet disiplinës dhe ndëshkimit, paraqitja e parimeve kryesore të disiplinimit, trajtimi i stileve të prindërimit dhe i rolit të secilit prej tyre te fëmijët, jepen këshilla për disiplinimin e tyre etj.

◆ **Kapitulli 7**

“Si e formojnë fëmijët konceptin e gjinisë” trajton identitetin gjinor dhe rolet gjinore në fëmijërinë e hershme. Çështje të tilla, si stereotipet gjinore në lojë, ndikimi i prindërve në identitetin gjinor të fëmijës, rëndësia e ndjekjes së kopshtit dhe të shkollës nga çdo fëmijë, djalë apo vajzë qoftë, janë në fokus të këtij kapitulli.

◆ **Kapitulli 8**

“Pse është i rëndësishëm partneriteti kopsht-familje” jep informacion për veprimtarinë mësimore-edukative që zhvillohet në kopsht. Partneriteti kopsht-familje është shumë i rëndësishëm për mirërritjen, kujdesin dhe edukimin e fëmijëve. Bashkëpunimi mësues-prind është vlerësuar gjithmonë si kyçi i suksesit të fëmijës, sidomos në moshën parashkollore. Çështje të tilla, si regjimi ditor në kopsht, organizimi dhe shfrytëzimi i kohës për realizimin e veprimtarisë mësimore-edukative, regjimi ditor dhe respektimi i ritmeve në një mjedis nxitës dhe bashkëveprues, standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve etj., janë disa nga temat që trajtohen në këtë kapitull.

◆ **Kapitulli 9**

“Të nxënë nëpërmjet lojës” trajton rëndësinë që ka loja në zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve. Loja është veprimtaria e tyre kryesore, nëpërmjet së cilës ata mësojnë, zbaviten, argëtohen dhe zbulojnë botën që i rrethon. Në këtë kapitull jepet një informacion i rëndësishëm për llojet e lodrave, të mjeteve dhe të lojërave që janë tipike për moshën parashkollore, me të cilat fëmija mund të luajë edhe në shtëpi.

◆ **Kapitulli 10**

“Probleme tipike të fëmijëve parashkollorë në sjellje dhe veprime” trajton problemet që shoqërojnë fëmijën gjatë rritjes, të nxitura nga kushtet dhe marrëdhëniet familjare, rrethanat apo mjedisi në të cilin fëmija jeton dhe rritet. Probleme të tilla, si sjellja dhe veprimet e dhunshme, agresiviteti, nervozizmi, gënjeshtat, mospranimi, fyerja apo sharja analizohen gjerësisht në këtë kapitull. Për prindërit ofrohen zgjidhje dhe strategji për pakësimin e veprimeve të dhunshme, për menaxhimin e emocioneve negative, për vetëkontrollin, të cilat ndikojnë në disiplinimin pozitiv të fëmijës.

◆ **Kapitulli 11**

“Si të ndihmojmë fëmijët të fitojnë shprehitë e zgjidhjes së problemit” është i ndërtuar mbi bazën e 10 aktiviteteve, të cilat kanë lidhje me dilemat dhe situatat problemore në të cilën gjenden shpesh fëmijët parashkollorë. Për secilin rast të paraqitur ngrihet problemi, ofrohen 3



zgjidhje dhe parashikohen pasojat e tyre. Këto situata e orientojnë prindin të ndihmojë fëmijën për të kuptuar problemin dhe për të gjetur zgjidhjen më të mirë.

Manuali ka edhe disa shtojca, të cilat përfshijnë:

- 10 të drejtat kryesore të fëmijës
- Treguesin e Mirëqenies së Fëmijës
- tipet e ndryshme të dhunës ndaj fëmijës
- ndikimin e punës së detyruar të fëmijës
- hapat kryesorë të zhvillimit të përgjithshëm të fëmijës sipas stadeve të zhvillimit
- standardet e zhvillimit dhe të të nxënies të fëmijëve 3-6 vjeç.

Grupi i punës që ka përgatitur materialin përbëhet nga specialistë të njohur të fëmijërisë së hershme, të cilët kanë kontribuar për vite të tëra në përgatitjen e dokumenteve, të strategjive dhe të materialeve në ndihmë të mësuesve të arsimit parashkollor, të prindërve dhe të fëmijëve nga mosha 0-6 vjeç.

Nxitje për hartimin e këtij manuali shërbeu nisma e Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit “Çdo fëmijë rom në kopsht”, mbështetja e UNICEF-it, kontributi dhe puna e palodhur në terren e tri organizatave.

Nora Malaj
Zëvendësministre e Arsimit dhe e Sportit

Kapitulli 1

"NDRYSHO 5 VITET E PARA TË JETËS DHE TI MUND TË NDRYSHOSH GJITHÇKA". ÇFARË DUHET TË DIJË PRINDI PËR FËMIJËT E MOSHËS 0 - 6 VJEÇ

Pse gjashtë vitet e para të jetës së fëmijës janë kaq të rëndësishme.

Gjashtë vitet e para, që njihen ndryshe edhe si vitet bazë të jetës, kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për të gjithë fëmijët. Jeta e fëmijës në këtë periudhë është përcaktuese në shumë drejtime për të ardhmen e tij. Kjo është pikërisht koha kur truri zhvillohet më shumë se asnjëherë tjetër, kur formohet intelijenca e fëmijës, identiteti i tij, sjellja e tij me të tjerët dhe veten. Këto vite të para kanë një ndikim të madh në ecurinë e fëmijës në jetë – që nga shëndeti e deri te suksesi në shkollë, vetëvlerësimi dhe aftësitë shoqërore të fëmijës. Truri është i vetmi organ i njeriut që nuk është formuar plotësisht kur lind fëmija. Gjatë viteve të para, në qelizat e trurit krijohen triliarda lidhje. Studimet tregojnë se këto lidhje formohen kryesisht nga përvojat që ka fëmija në këto vite, ndaj, sa më shumë përvoja pozitive, aq më shumë lidhje do të formohen duke mundur kështu zhvillimin e një truri dhe personaliteti të shëndetshëm.

Kjo periudhë e rëndësishme në zhvillimin e fëmijës ofron mundësi të arta për të, por ajo është në të njëjtën kohë edhe një periudhë kur këto shanse mund të humbasin. Kujdesi i paktë dhe jo i duhur në këto vite të para reflektohet më pas me ndjenja pakënaqësie ndaj jetës, marrëdhënie problematike, vështirësi në të nxënë, çrregullime në të ngrënë, e deri në nivele të larta krimi dhe dhune që fillojnë shpesh që në adoleshencë, varësi nga droga dhe probleme të tjera personale



e sociale. Këto çrregullime është e vështirë të trajtohen më vonë e shpesh përpjekjet kanë pak ose aspak rezultat.

Parimet e zhvillimit të trurit

- ◆ Përvojat formësojnë anatominë e trurit
- ◆ Përvojat përjetohen përmes shqisave – shikimit, dëgjimit, nuhatjes, prekjes dhe shijes, të cilat i lejojnë trurit të ndryshojë lidhjet e tij me qelizave
- ◆ Truri punon me parimin “përdore ose humbe”
- ◆ Marrëdhëniet me njerëzit e tjerë në vitet e para të jetës janë burimi kryesor i zhvillimit i pjesëve përgjegjëse në tru për emocionet dhe marrëdhëniet.

E rëndësishme për prindin

- ◆ 90% e trurit të fëmijës zhvillohet brenda 5 viteve të para të jetës. 87% të peshës së trurit fëmija e arrin në moshën 3-vjeçare.
- ◆ Në moshën 3-vjeçare truri i fëmijës është 3 herë më aktiv sesa truri i të rriturve.
- ◆ Truri zhvillohet me maksimumin e shpejtësisë gjatë viteve të para të jetës (te fëmijët e vegjël qelizat e trurit krijojnë 700 deri në 1000 lidhje të reja çdo sekondë).
- ◆ Zhvillimi optimal i trurit kërkon një mjedis stimulues, ushqyerje të kujdesshme dhe ndërveprim social me të rritur të kujdesshëm.
- ◆ Në zhvillimin e hershëm të trurit ndikojnë një numër faktorësh, si: përvojat e përditshme, gatishmëria për t’iu përgjigjur fëmijës, ushqimi, aktiviteti fizik, gjenet dhe dashuria.
- ◆ Sa më herët të ndërhyhet, aq më shpejt dhe më mirë mund t’i rikuperojë truri dëmtimet.
- ◆ Kequshqyerja dëmton zhvillimin normal të trurit
- ◆ Stresi i fortë te fëmijët e vegjël dhe ekspozimi i tyre ndaj dhunës, abuzimit, neglizhimit gjatë viteve të para ka pasoja për gjithë jetën.
- ◆ Siguria është domosdoshmëri në vitet e para të jetës

Edhe pse çdo fëmijë ka ritmet e tij të zhvillimit, shumë studime tregojnë se zhvillimi më i shpejtë në jetë ndodh gjatë periudhës 0-3 vjeç. Gjatë kësaj periudhe, e sidomos gjatë vitit të parë të jetës, fëmijët jetojnë në privatësinë



e shtëpisë së tyre dhe varen plotësisht nga të rriturit. Për këtë arsye, aftësitë prindëruese janë thelbësore në rritjen e fëmijëve, duke u mundësuar atyre mbështetje emocionale, duke inkurajuar zhvillimin e duke ndërtuar një komunikim të shëndetshëm me ta. Shumica e prindërve, megjithatë, nuk kanë pasur ndonjëherë mundësi të mësojnë aftësitë e prindërimit. Mbështetja e prindërve për këtë periudhë, mësimi i teknikave të prindërimit pozitiv do t'i ndihmojë në edukimin dhe formimin e mirë të fëmijëve. Po kështu, përmes dashurisë prindërore, ata do ti japin fëmijëve një mundësi më të mirë për sukses, lumturi në jetë dhe një shoqëri më të mirë e të shëndetshme.

Përvojat dhe marrëdhëniet që fëmija ka në këto vite, së bashku me cilësinë e ushqimit dhe kujdesin për shëndetin, ndikojnë shumë në të ardhmen e tij. Nëse fëmija ka përvoja pozitive në këtë periudhë, atëherë edhe truri i tij do të zhvillohet në mënyrë të shëndetshme. Por, nëse me fëmijën do të abuzohet ose ai do të neglizhohet, kjo do të ndikojë në trurin e tij duke e dëmtuar dhe duke bërë që fëmija të ketë probleme me sjelljen dhe emocionet në vitet e mëvonshme. Ndaj është e rëndësishme të kuptohet se përvojat e përditshme që fëmija ka në vitet e para ose e ndihmojnë ose e pengojnë zhvillimin dhe procesin e të nxënës.

Të kujdesesh mirë për fëmijën në këtë kohë ka përfitime të jashtëzakonshme për të dhe për gjithë familjen. Nëse të rriturit që duhet të kujdesen për të, e neglizhojnë apo e lënë "të rritet vetë" gjatë kësaj periudhe, pasojat mund të jenë afatgjata

Pavarësisht ndikimit të madh që ka varfëria, ajo që është më e rëndësishme për një fëmijë në vitet e para, është krijimi i një marrëdhënieje të sigurt me prindin, që i jep besim, dashuri dhe nxit zhvillimin e tij. Mjedisi më i rëndësishëm që ndikon në jetën e fëmijës, është mjedisi i shtëpisë. Studimet tregojnë se, kur prindërit janë në gjendje të ndërtojnë marrëdhënie dhe përvoja të shëndetshme me fëmijët gjatë viteve të para, edhe atëherë kur familjet janë të varfëra apo vijnë nga minoritete ose etni të ndryshme dhe përballen me shumë vështirësi, ato ndryshojnë të ardhmen e fëmijëve. Sigurisht që, përveç kësaj, fëmija ka nevojë për shërbime cilësore shëndetësore, edukuese dhe sociale.

Prandaj është me rëndësi jetike që fëmija të shkojë në kopsht dhe me pas në shkollë. Atë duhet ta ndihmoni dhe të përpiqeni t'i ofroni një mjedis të sigurt dhe nxitës, çka e bën të zhvillojë inteligjencën, marrëdhëniet dhe gjuhën.

Faktorët kryesorë për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës në vitet e para

Ka disa faktorë kryesorë që ndikojnë në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës në këto vite kyçe.

1. Shëndeti i fëmijës ndikohet nga ajo që ndodh gjatë shtatëzanisë si dhe 3 viteve të para të jetës, por dhe nga shëndeti i nënës e sjelljet e saj gjatë shtatëzanisë. Pështja e lindjes së foshnjës, ushqyerja me gji, pirja e duhanit ose qëndrimi në mjedis me duhan, vaksinat janë disa nga faktorët kryesorë që ndikojnë në shëndetin e fëmijës.
2. Cilësia e marrëdhënies mes prindërve, cilësia e kujdesit për fëmijën e vogël dhe lidhja që ndërtohet mes bebes dhe prindërve ndikojnë në procesin e të mësuarit dhe arritjet në

- shkollë, në aftësitë shoqërore, vetëvlerësimin, sjelljen si dhe shëndetin mendor e fizik.
3. Shëndeti mendor i prindërve lidhet ngushtë me zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës, sidomos me zhvillimin e tij shoqëror, emocional dhe të sjelljes.
4. Aktivitetet që prindërit bëjnë me fëmijët në shtëpi, si p.sh. bisedat, leximi i librave, loja me ta përcaktojnë zhvillimin e ardhshëm të fëmijës dhe dëshirën e tij për të shkuar në shkollë. Një mjedis familjar që nxit mësimin e fëmijës, ka ndikim më të madh se faktorët social- ekonomikë, statusi, niveli arsimor i nënës dhe të ardhurat e familjes.
5. Edukimi i hershëm cilësor është thelbësor në arritjet e fëmijëve, sidomos të atyre që vijnë nga familje/komunitete në vështirësi, sepse shumica e fëmijëve që arrijnë një nivel të mirë zhvillimi në vitet e para, vazhdojnë kështu edhe më pas.

Nxitja e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijët e vegjël dhe përgatitja për shkollën **10 udhëzime të rëndësishme**

- ◆ Jini të dashur dhe komunikues
- ◆ Përgjigjiuni fëmijës çdo herë që ai komunikon me ju në mënyrën e vet
- ◆ Flitini, lexojini dhe këndojini fëmijës
- ◆ Vendosni rutina dhe rituale të përditshme
- ◆ Inkurajoni eksplorimin dhe lojën e sigurt
- ◆ Kufizojini televizorin dhe përzgjidhni emisionet që duhet të shohë fëmija
- ◆ Përdoreni disiplinimin si një mundësi për ta mësuar fëmijën
- ◆ Pranoni se çdo fëmijë është i veçantë
- ◆ Përzgjidhni një çerdhe/kopsht cilësor për fëmijën tuaj
- ◆ Kujdesuni për veten

Pyetje për prindërit për të reflektuar

- ◆ Sa kohë kaloni me fëmijën?
- ◆ Çfarë bëni gjatë kësaj kohe?
- ◆ Si e përfshini fëmijën në këto aktivitete?
- ◆ Çfarë aktivitete/lojërash pëlqen fëmija?
- ◆ Çfarë bën fëmija juaj kur është i mërzhitur, i zemëruar, i lodhur?
- ◆ Çfarë ndodh kur fëmija juaj qan për një kohë të gjatë, shpërthen në zemërim, largohet nga shkolla?
- ◆ Si e tregon dashurinë dhe afeksionin në familje?
- ◆ Si ia bëni të ditur fëmijës se e doni?
- ◆ Cilat janë aftësitë dhe talentet e fëmijës suaj? Si i inkurajoni këto talente të tijat?
- ◆ Si reagoni kur fëmija juaj bën diçka jo të zakonshme?

Kapitulli 2

NEVOJAT BAZË TË FËMIJËVE TË VEGJËL INFORMACION I DOMOSDOSHËM PËR ÇDO PRIND

Cilat janë nevojat bazë të fëmijëve në këtë moshë.

Fëmijët kanë shumë nevoja, por disa prej tyre konsiderohen si nevoja bazë, pa plotësimin e të cilave ata nuk mund të zhvillohen të shëndetshëm. Si prind, është detyra juaj t'ia plotësoni këto nevoja. Fëmija ka nevojë për ndihmën e të rriturit, që të ndihet i sigurtë, të rritet i shëndetshëm dhe i gatshëm për të mësuar.

- **NEVOJAT FIZIKE**

Të ketë ushqim të shëndetshëm, një vend të pastër e të sigurtë ku të jetojë; të jetë i mbrojtur nga rreziqet dhe dëmtimi; të jetë i pastër.

- **NEVOJAT EMOCIONALE**

Të ndjejë nga ju kujdesin, sigurinë, dashurinë, kurajon dhe shpresën.

- **NEVOJAT SOCIALE**

Të ndërveprojë e të komunikojë me ju dhe të tjerët, të ketë kohë dhe mundësi të luajë me ju dhe fëmijë të moshës së vet.

- **NEVOJAT PSIKOLOGJIKE**

Të dijë se është shumë i rëndësishëm për ju, të ketë mundësi të mësojë për gjërat që i pëlqejnë dhe ato që nuk i pëlqejnë, të ketë mbështetjen tuaj që të zhvillojë vetëvlerësim.

- **TË ZHVILLOJË AFTËSITË PËR SHKOLLË**

Të mësojë përmes komunikimit dhe lojës me ju për t'i nxitur aftësitë gjuhësore, si dhe t'ju dëgjojë t'i lexoni libra.

Çfarë duhet të dijë prindi kur diçka nuk po shkon si duhet në zhvillimin e fëmijës së tij.

Të jesh prind, do të thotë të jesh dëshmitar i rritjes dhe i zhvillimit të fëmijës tënd në çdo hap. Prindi duhet të vëzhgojë me kujdes fëmijën dhe mënyrën se si ai zhvillon çdo ditë aftësi dhe arritje të reja. Në disa raste fëmija nuk zhvillohet si duhet dhe prindi duhet të jetë i pari që ta

kuptojë se fëmija i tij ka nevojë për ndihmë. Nëse ju si prind vini re se fëmija juaj ka një apo disa shenja nga lista e mëposhtme, atëherë kërkon menjëherë NDIHMË.

Foshnja nën moshën 8-muajshe

- ◆ nuk shton në peshë
- ◆ nuk të sheh në sy e nuk i ndjek me sy objektet pranë tij
- ◆ nuk e ngre dot kokën
- ◆ nuk mban dot gjëra në duar
- ◆ nuk u përgjigjet zhurmave të forta

Foshnja nga 9- deri në 12-muajsh

- ◆ nuk ecën këmbadorazi
- ◆ nuk rri dot ulur edhe kur e ndihmoni
- ◆ nuk përdor gjestet, si p.sh. të tundë dorën për të thënë "mirupafshim"
- ◆ nuk komunikon me të tjerët, nuk buzëqesh, nuk gugat e nuk tregon interes për lojën.

Fëmija nga 18- deri në 24-muajsh

- ◆ nuk thotë fjalë (si p.sh. "mama")
- ◆ nuk arrin të ecë
- ◆ ka tundje apo dridhje të trupit
- ◆ ka shqetësime në gjumë

Fëmija 3-vjeçar

- ◆ rrëzohet shpesh dhe ka vështirësi për të ngjitur shkallët
- ◆ nuk arrin të ndërtojë një "pallat" me më shumë se 4 kuba
- ◆ nuk arrin të flasë me fjali me 3 fjalë (p.sh. "unë dua ujë")
- ◆ nuk shfaq interes për fëmijët e tjerë

Fëmija 4-vjeçar

- ◆ nuk arrin ta mbajë lapsin mes gishtave
- ◆ nuk shfaq interes në lojën me të tjerët
- ◆ nuk arrin të thotë më shumë se 3 fjalë së bashku në një fjali
- ◆ zemërohet e inatoset dhe nuk di të ndalojë

Fëmija 5-vjeçar

- ◆ nuk arrin të tregojë se çfarë ka bërë gjatë ditës
- ◆ është pjesën më të madhe të kohës shumë i mërziur e i pakënaqur
- ◆ është shumë agresiv
- ◆ nuk arrin të përqendrohet në një aktivitet për më shumë se 5 minuta
- ◆ nuk shfaq interes për të luajtur me fëmijët e tjerë

♦ nuk njeh emocionet bazë të njeriut, si gëzimin, trishtimin, habinë, inatin etj.

Çfarë duhet të bëni kur shihni këto shenja paralajmëruese

- ♦ Dërgojeni fëmijën te mjeku dhe bisedoni me të rreth asaj që vini re te fëmija.
- ♦ Bisedoni me stafin e çerdhes/kopshtit për atë që keni vënë re te fëmija.
- ♦ Bisedoni me përfaqësuesit e komunitetit/lagjes suaj. Kërkoni që fëmija të vlerësohet me kujdes.



MOS HARRONI:

Bebet janë shumë delikate. Kurrë mos e shkundni një bebe.

Kapitulli 3

“ËSHTË MË E LEHTË TË FORMOSH FËMIJË TË FORTË SESA TË RIPAROSH NJERËZ TË DËMTUAR”

Pse prindi është mësuesi i parë i fëmijës

Ju si prind jeni model për fëmijën tuaj. Roli juaj është shumë i rëndësishëm në zhvillimin dhe mësimin e tij. Gjithçka që ju bëni së bashku, janë mësimet të rëndësishme që do ta ndihmojnë të rritet dhe të njohë botën.

Pse është e nevojshme që prindërit të kenë njohuri për zhvillimin e fëmijës

Prindërit që kanë informacion të mjaftueshëm për stadet e zhvillimit të fëmijës në çdo moshë, kanë më shumë mundësi të komunikojnë me respekt me fëmijën, të përcaktojnë rregulla dhe pritshmëri të qarta ndaj tij, t'i vendosin kufij në përputhje me moshën dhe t'i japin mundësi të ndërtojë pavarësinë. Megjithatë, asnjë prind nuk është ekspert në gjithçka që lidhet me jetën e fëmijës. Kur prindërit nuk e dinë se ç'është e zakonshme për një moshë të caktuar, ata e interpretojnë gabim sjelljen e fëmijës dhe, për pasojë, nuk dinë ta rregullojnë atë dhe acarohen e kalojnë në përdorimin e dhunës.

Informacioni për edukimin e fëmijëve mund të vijë nga shumë burime, si p.sh. nga gjyshërit dhe familjarët, nga praktikant kulturorë, media, kurset apo trajnimet që prindërit kanë ndjekur, si dhe nga burime të tjera në komunitet. Edhe vëzhgimi i prindërve të tjerë, që përdorin mënyra pozitive për rritjen e fëmijës, jep mundësi për të mësuar alternativa të tjera të shëndetshme.

Ç'kuptojmë me zhvillim të fëmijës

Zhvillimi i fëmijës është ndryshimi në aftësitë e tij fizike, njohëse (të menduarit, të arsyetuarit), sociale dhe emocionale. E nëse çdo fëmijë rritet dhe zhvillohet me ritmin e tij, të gjithë fëmijët ndjekin modele apo hapa të njëjtë. Fëmijët i zhvillojnë aftësitë në këto fusha kryesore:

Zhvillimi fizik – “Unë jam në lëvizje” ka të bëjë me maturimin e aftësive që lejojnë kontrollin



e trupit; me zhvillimin dhe rritjen e trupit, të muskujve dhe të shqisave të fëmijëve. Kemi dy lloje muskujsh: muskujt e mëdhenj, të cilët përdoren për të ecur apo për t'u ulur e ngritur, dhe muskujt e vegjël, që fëmija mund t'i përdorë për të kapur objektet apo për treguar me gisht. Zhvillimi i muskujve njihet ndryshe edhe si zhvillimi motorik global ose fin sipas shembujve më lart.

Zhvillimi njohës apo intelektual – “Unë mendoj” ka të bëjë me aftësinë e fëmijës për të menduar, dëgjuar e kuptuar të tjerët si dhe për të ndjekur udhëzimet. Kjo fushë e zhvillimit përfshin edhe mënyrën se si fëmijët mendojnë, arsyetojnë, kujtojnë, përqëndrohen në një detyrë të caktuar dhe zgjidhin problemet. Pjesë e tij janë imagjinata dhe kreativiteti.

Zhvillimi gjuhësor dhe i komunikimit – “Unë them atë që mendoj” ka të bëjë me aftësinë e fëmijës për të dëgjuar, kuptuar e përdorur fjalët e mësuara në bazë të kontekstit me qëllim që të vetëshprehet.

Zhvillimi socio-emocional – “Unë jam i rëndësishëm” ka të bëjë me aftësinë e fëmijës për të kuptuar se ka një “vete”; me aftësinë për të vetërregulluar emocionet, për të krijuar dhe mbajtur marrëdhëniet me të tjerët.

Zhvillimi i fëmijës është tërësor

Rritja në fushat shoqërore, emocionale, fizike ose njohëse të fëmijët e vegjël nuk ndodh e izoluar. Edhe pse është më e thjeshtë ta ndajmë zhvillimin në fusha, në mënyrë që të mësojmë dhe të mendojmë rreth tij, është e rëndësishme të kuptojmë se fëmija nuk zhvillohet në fusha të ndara, por në tërësi si person. Zhvillimi i fëmijës, pra, është tërësor. Progresi në një fushë ndikon dhe ndikohet nga fushat e tjera.

Si rriten dhe zhvillohen fëmijët në këtë moshë

Fëmijët e vegjël nga mosha 0 – 6 vjeç përjetojnë ndryshime të mëdha. Gjatë dy viteve të para ata kanë një zhvillim të rëndësishëm në aftësitë e tyre fizike, motore, emocionale, njohëse dhe gjuhësore. Ata mësojnë të ulen, të lëvizin këmbadoras e më pas të ecin vetë. Ata kuptojnë shumë si dhe arrijnë të shprehen, ndonëse me një fjalor të kufizuar. Ata nuk e kanë ende të qartë sensin e kohës. Kujtesa e tyre nuk është e organizuar mirë dhe emocionet i kanë të forta. Zhurmat dhe përvojat e reja mund t'i përjetojnë me frikë e ankth. Formimi i lidhjeve të sigurta me një të rritur që i plotëson nevojat në kohë, është mënyra e vetme dhe baza për një zhvillim të shëndetshëm në të ardhmen.

Disa udhëzime bazë për ta kuptuar fëmijën tuaj

Ta kuptoni fëmijën tuaj është një ndër gjërat më të rëndësishme që çdo prind duhet të mësojë. Falë kësaj, ju mund t'ia arrini të kujdeseni dhe t'i drejtoni ata sa më mirë, pasi çdo fëmijë është i veçantë. Një ndër mënyrat për ta kuptuar fëmijën është ta vëzhgoni kur fle, kur ha, kur luan. Shihni me kujdes veçoritë e tij. Cilat aktivitete i pëlqejnë më shumë? A përshtatet lehtë ndaj ndryshimit apo ka nevojë që të njihet dhe të familjarizohet me gjërat?

Përpiquni të keni kohë të bisedoni e të komunikoni me të, pasi kjo do t'ju japë më shumë mundësi

të mblidhni informacion dhe ta kuptoni më mirë. Në rastin e fëmijëve të vegjël, ata kërkojnë më shumë komunikim me gjeste sesa me fjalë, ndaj është e rëndësishme të kuptoni gjuhën e tyre të trupit, gjestet dhe shprehjet e fytyrës. Pyetini fëmijët, në mënyrë që të kenë mundësi t'i shprehin emocionet me ju. P.sh. në vend që t'i pyesni se çfarë bënë në kopsht, pyetini se çfarë bënë me kubat. Shikoni me kujdes mjedisin rrethues të fëmijës për të kuptuar më mirë sjelljet që ka mësuar. Ju mund t'i kuptoni edhe kur i krahasoni me bashkëmoshatarët e tyre, ndaj është e rëndësishme të njihni zhvillimin dhe sjelljet tipike të fëmijës në çdo moshë. Duke kuptuar zhvillimin e tij, mund t'i jepni mundësi të luajë duke nxitur kështu zhvillimin e tij dhe përgatitjen për fazat e mëtejshme të rritjes. Sigurisht që është e vështirë të jesh prind i mirë e të shpenzosh kohë cilësore me fëmijën, sidomos nëse keni shumë vështirësi të tjera (ekonomike e sociale), por të kuptuarit e fëmijës është një element shumë i rëndësishëm për të qenë prind i suksesshëm.

Cilët janë prindërit rezilientë

Prindërit që përballen mirë me streset e jetës së përditshme, por edhe me krizat, janë ata që kanë më shumë fleksibilitet. Kjo do të thotë që ata përshtaten dhe kanë forcë të brendshme për të mos u thyer kur gjërat nuk shkojnë mirë. Këta prindër dinë si të kërkojnë ndihmë në kohë të vështira. Aftësia e tyre për t'u përballur me të tatëpjetat e jetës, shërben si model sjelljeje për fëmijët. Kjo gjë i ndihmon ata të mësojnë vetë rregullat dhe aftësitë për të zgjidhur problemet. Faktorët stresues të jetës, siç janë abuzimet në familje, problemet e shëndetit mendor, konfliktet mes bashkëshortëve, abuzimi me drogën, dhuna në shtëpi e komunitet si dhe papunësia, pasiguria finaciare e mungesa e strehimit mund të ulin kapacitetin e prindit për t'u përballur mirë me streset e jetës së përditshme në rritjen e fëmijëve. Përkundrazi, një mjedis pozitiv e mbrojtës në komunitet si dhe dhënia e mundësive ekonomike përmirëson reziliencën e prindërve. Të gjithë prindërit kanë forcë dhe burime të brendshme për ndërtimin e reziliencës. Këto janë besimi, fleksibiliteti, humori, aftësitë komunikuese, aftësitë për të zgjidhur problemet, krijimi i marrëdhënieve të mira apo mundësia për të identifikuar dhe pasur burime e shërbime nga jashtë komunitetit, kur është e nevojshme. Të gjitha këto cilësi forcojnë kapacitetin e tyre për të ushtruar në mënyrë të efektshme rolin si prindër.

Pse është i rëndësishëm kujdesi dhe lidhja e shëndetshme me fëmijën

Shumë prindër, sidomos ata me të ardhura të pakta e të pasigurta, në përpjekje për t'i siguruar familjes financat e nevojshme, nuk kanë kohë të mjaftueshme të rrinë me fëmijët. Duhet të dimë që edhe veprime fare të thjeshta e që nuk kërkojnë kohë, si përqafimi, buzëqeshja apo fjalët që shprehin dashuri, sjellin një ndryshim të madh tek ai.

Studimet tregojnë se fëmijët e vegjël që marrin dashuri dhe përkujdesje nga prindërit, kanë më shumë mundësi për t'u bërë fëmijë, adoleshentë dhe të rritur të lumtur e të shëndetshëm. Po këto studime tregojnë se një marrëdhënie e qëndrueshme me të rritur që kujdesen mirë në vitet e para të jetës, "sjell" rezultate më të larta në mësim, mënyra sjelljeje më të shëndetshme, marrëdhënie më të mira me shokët dhe aftësi më cilësore për të përballuar situatat stresuese.

Truri i foshnjëve zhvillohet në mënyrë të shëndetshme, nëse të rriturit që kujdesen për të

përmbushin nevojat e tij për dashuri dhe stimulim. Përkundrazi, prindërimi abuziv dhe neglizhues mund të ketë pasojë negative në zhvillimin e trurit. Mungesa e kontaktit dhe e marrëdhënies me një të rritur mund të ndryshojë nivelin e hormoneve të rritjes, të cilat janë të rëndësishme për trurin dhe zemrën. Pa këtë marrëdhënie të hershme, fëmijët do të kenë probleme në ndërveprimin me fëmijët e tjerë. Edhe me rritjen e fëmijës, kujdesi për shëndetin fizik dhe emocional të tyre mbetet i rëndësishëm.

Çfarë thonë studimet

- ◆ Edhe prindërit më vulnerabël mund të përfshihen në edukimin e fëmijëve dhe në krijimin e mjedisve nxitëse në shtëpi
- ◆ Sjellja e prindërve ndikon në zhvillimin e fëmijës që nga çasti që foshnja është në barkun e nënës
- ◆ Cilësia e mjedisit të shtëpisë, si një mjedis që nxit të mësuarin e fëmijës, është më i rëndësishëm për zhvillimin intelektual dhe shoqëror të fëmijës sesa profesioni i prindit, arsimimi apo të ardhurat e tij.
- ◆ Fëmijët, baballarët e të cilëve i ndihmojnë ata në mësim, janë më mirë në shkollë dhe kanë shëndet më të mirë mendor
- ◆ Ndikimi i shtëpisë është i drejtpërdrejtë, afatgjatë dhe i pakthyeshëm

Çfarë mësojnë fëmijët nga prindërit

Fëmijët, që nga dita e parë e jetës, janë të gatshëm të mësojnë dhe janë shumë të interesuar për mjedisin rreth tyre. Ata mësojnë për veten, njerëzit e tjerë e botën që i rrethon, si dhe luajnë rol shumë aktiv në mësimin dhe zhvillimin tyre me anë të eksplorimit. Nuk ka asnjë dyshim për mundësitë fantastike e gati të pabesueshme që kanë fëmijët për të mësuar. Ajo që pritet nga prindi, është të qëndrojë me fëmijën e të dëshmojë arritjet e tij dhe dijen e madhe që ai fiton përgjatë viteve të para të jetës.

Zhvillimi dhe mësimi i fëmijëve varen nga faktorë të tillë, si:

- ◆ ndikimet e vetë fëmijës
- ◆ trashëgimia gjenetike, temperamenti, gjinia dhe shëndeti
- ◆ ndikimet brenda familjes
- ◆ marrëdhëniet në familje, si stilet e prindërimit, situata financiare në familje, niveli i arsimimit të prindërve, puna dhe profesioni i prindërve, shëndeti fizik dhe mendor i prindërve
- ◆ ndikimet nga komuniteti, ku bëjnë pjesë shërbimet për fëmijët, mbështetja që u jepet prindërve nga komuniteti ku jetojnë, niveli i sigurisë dhe i krimit në komunitet, nivelet e papunësisë dhe mirëbesimi i përgjithshëm mes banorëve të komunitetit
- ◆ ndikimet nga kultura e tyre, pasi kultura ndikon në stilin e prindërimit, në bindjet e vlerat si dhe në mënyrën si duhet të edukohen fëmijët.

Cilat janë disa nga fushat më të rëndësishme për mësim

Shëndeti dhe mirëqenia fizike janë bazat e mësimi dhe të zhvillimit. Fusha të tilla, si zakonet e të ngrënit, qëndrimet ndaj ushtrimeve sportive dhe kujdesit për veten ndërtohen nga përvojat më të hershme të fëmijës. Një ndër gjërat kryesore e të rëndësishme që fëmijët mësojnë në vitet e para është dija për veten, çka do të thotë se ata zhvillojnë një imazh të vetes që ndikon në mënyrën sesi ata përballen me situata të ndryshme, me detyrat apo me marrëdhëniet me njerëzit. Me fjalë të tjera, ata ndërtojnë konceptin për veten.

Një pjesë e rëndësishme e këtij koncepti është edhe imazhi që ata ndërtojnë për veten si nxënës: a është mirë të jenë kuriozë, të eksplorojnë, të pyesin, të zgjidhin probleme, të zbulojnë, të eksperimentojnë? A është normale të provojnë diçka e ndonjëherë të dështojnë? Të jesh një nxënës i mirë, do të thotë ta shohësh veten si të aftë e të guximshëm për të rrezikuar pak. Ka shumë mënyra se si mund të kategorizohet të nxënit dhe mësimi në vitet e para të jetës, por, pavarësisht nga kjo, është e rëndësishme që prindërit dhe personat e tjerë që kujdesen dhe rrinë me fëmijët, të dinë se sa gjëra mëson fëmija me ta në vitet e para të jetës.

Disa nga fushat e mësimi të fëmijës në vitet e para janë:

- ◆ përdorimi i trupit, përfshirë këtu dhe duart
- ◆ respekti për të tjerët
- ◆ mënyra se si të krijojnë marrëdhënie me të tjerët (të rritur dhe fëmijë)
- ◆ si të zgjidhin konfliktet
- ◆ aftësitë për zgjidhjen e problemeve
- ◆ komunikimi
- ◆ të kuptuarit e ndjenjave, të pikave të forta, të dhuntive dhe veçantive të vetes
- ◆ vetëbesimi
- ◆ ndjenja e përkatësisë në familje, komunitet dhe kulturë
- ◆ kujdesi për veten
- ◆ sjellja e duhur dhe kontrolli i sjelljes



Kapitulli 4

PSE MBROJTJA FILLON NË FAMILJE

Të kuptojmë abuzimin dhe neglizhimin e fëmijës

Kur përkujdesemi si duhet për fëmijët, ata rriten të lumtur dhe të shëndetshëm. Por, nëse atyre u mungon lidhja me një të rritur që përkujdeset rregullisht për ta ose përjetojnë forma të ashpra disiplinimi, pasojat mund të ndikojnë në shëndetin e tyre afatgjatë, në mirëqenien dhe marrëdhëniet me të tjerët.

Çfarë është abuzimi dhe neglizhimi i fëmijës

Abuzimi dhe neglizhimi i fëmijës shpesh ndodh në shtëpi nga një person që e njeh mirë fëmijën – prindi, i afërmi, miku i familjes. Ka 4 tipe kryesore të keqtrajtimit të fëmijës. Edhe pse secila nga format mund të shfaqet e veçuar, ato zakonisht vijnë bashkë.

Neglizhimi është një mungesë e vazhdueshme e serioze e kujdesit dhe e vëmendjes, me ose pa qëllim, nga prindërit/kujdestarët ndaj nevojave të fëmijës për strehë, siguri, mbikëqyrje, ushqim, shëndet dhe arsim, që sjell dëmtim fizik dhe/apo emocional të fëmijës. Abuzimi fizik është dëmtimi fizik i fëmijës si rezultat i goditjes, shuplakës, shkundjes, djegies, kafshimit apo formave të tjera dëmtuese.

Abuzimi seksual nënkupton çdo situatë ku fëmija përdoret për kënaqësi seksuale. Kjo mund të përfshijë ekspozimin e fëmijës ndaj materialeve e pamjeve me natyrë seksuale, përdhunimin, shfrytëzimin për përfitime

financiare përmes prostituimit apo prodhimit të materialeve pornografike.

Abuzimi emocional nënkupton çdo model sjelljeje që dëmton zhvillimin emocional të fëmijës apo ndjenjën e tij të vetëvlerësimit, përfshirë këtu kritikën e vazhdueshme, kërcënimin dhe refuzimin.

Pse ndodh abuzimi me fëmijën

Abuzimi dhe neglizhimi i fëmijës prek çdo fëmijë të çdo race, moshe dhe niveli ekonomik. Megjithatë, studimet kanë identifikuar disa faktorë që kanë të bëjnë me fëmijën, familjen, komunitetin dhe



shoqërinë, që lidhen ngushtë me riskun e madh për abuzim dhe neglizhim. Po këto studime tregojnë se, kur bëhen bashkë shumë faktorë risku, mundësitë për abuzim janë edhe më të mëdha.

Disa nga faktorët kryesorë që çojnë në abuzimin e fëmijëve janë:

- ◆ Papjekuria dhe mosha e re e prindërve. Prindërit në moshë të re mund të kenë mungesë informacioni dhe janë të papërgatitur për përgjegjësitë e rritjes së një fëmije.
- ◆ Pritshmëritë jorealiste. Mungesa e njohurive për zhvillimin normal të fëmijës mund të çojë në acarim dhe disiplinë abuzive.
- ◆ Stresi. Familjet që përballen me varfëri, strehim të përkohshëm dhe të pastabilizuar, divorc ose papunësi mund të jenë në risk më të madh.
- ◆ Abuzimi me drogën. Pasojat e përdorimit si dhe koha, energjia, paratë e shpenzuara për të marrë drogë apo alkool, dëmtojnë ndjeshëm aftësitë e prindërve për t'u përkujdesur për fëmijët e tyre.
- ◆ Modelet e abuzimit në breza. Përvojat traumatike të fëmijërisë së vetë prindërve mund të ndikojnë në marrëdhëniet e tyre me fëmijët.
- ◆ Izolimi. Prindërimi efektiv është më i vështirë kur prindërve u mungon një partner, familje apo komunitet mbështetës.

Pasojat kryesore të dhunës ndaj fëmijës

Dhuna i heq fëmijës besimin te vetja e te të tjerët si dhe ia zbeh gjithë gjallërinë dhe gëzimin e natyrshëm.

Më konkretisht, dhuna dëmton:

- ◆ Emocionet e fëmijëve. Këta fëmijë përjetojnë shpesh situata ankthi, ndihen fajtorë ose përgjegjës për çka ndodh. Këta fëmijë ndihen shumë në turp, sidomos në rastet e dhunës seksuale. Ata mund të ndihen të zemëruar dhe kanë luhajtje të gjendjes emocionale.
- ◆ Marrëdhëniet me familjen dhe shoqërinë. Fëmijët që përjetojnë dhunë, mund të izoloohen nga të tjerët.
- ◆ Vetërespektin dhe vetëvlerësimin
- ◆ Arritjet në mësim, ambiciet dhe mundësitë për t'u arsimuar

Dhuna ka pasoja fizike.

Ajo sjell ndryshime të pashpjegueshme në sjellje dhe reagime.

Cilat janë pasojat

Keqtrajtimi i fëmijës është një përvojë traumatike me pasoja shumë të rënda.

Ngjarjet traumatike, si ato të izoluarat ashtu edhe ato të vazhdueshmet, mbysin aftësinë e fëmijës për të përballuar realitetin dhe nxisin reagime të forta emocionale. Këto reagime vazhdojnë edhe kur rreziku ka kaluar, deri sa të merret trajtimi i nevojshëm.

Ngjarje të tilla traumatike mund të dëmtojnë aftësinë e fëmijës për t'iu besuar të tjerëve, ndjenjën e tyre të sigurisë dhe përparimin në jetë.

Trauma e abuzimit ose e neglizhimit mund të shoqërohet me :

- ♦ depresion dhe përpjekje për vetëvrasje, sidomos në adoleshencë
- ♦ abuzim me drogën
- ♦ aftësi të kufizuar apo vështirësi në të nxënë
- ♦ probleme sociale, probleme me të rriturit, por edhe probleme të ndërveprimit me fëmijët e tjerë
- ♦ shtatëzani në periudhën e adoleshencës
- ♦ dështime në shkollë
- ♦ dhunë ndaj familjarëve
- ♦ sëmundje kronike

Nëse dyshoni apo jeni dëshmitar i abuzimit ose i neglizhimit të fëmijës, duhet të raportoni menjëherë. Nëse mendoni se një fëmijë është keqtrajtuar, merrni masa menjëherë.

Telefononi në numrin 129 ose në nr 116 (ALO 116 - CRCA) ose kontaktoni me punonjës të punonjësin për mbrojtjen e fëmijës pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës.

Lloji i abuzimit	Simptomat
neglizhimi	▪ shenja të kequshqyerjes ▪ mungesë higjienë ▪ probleme fizike a mjekësore të lëna pas dore
abuzimi fizik	▪ dëmtime, djegie apo plagë pa ndonjë arsye të qartë ▪ frikë nga të rriturit
abuzimi seksual	▪ dhembje, gjakrrjedhje, skuqje apo rrjedhje në zonën gjenitale ose anale ▪ lojëra seksuale të papërshtatshme për moshën ▪ njohuri të papërshtatshme për moshën mbi seksin dhe marrëdhëniet seksuale.
abuzimi emocional	▪ sjellje ekstreme (nga shumë agresive në shumë pasive) ▪ zhvillim fizik, emocional dhe intelektual i dëmtuar.



Pse është e rëndësishme që fëmijët të përfshihen në vendimet që merren në familje

Mësohuni ta përfshini fëmijën që kur është i vogël në çdo vendim që ndikon në jetën e tij. Sigurisht që nuk është e lehtë për ju të mësoni nga fëmijët apo t'i ndryshoni mendimet dhe idetë në bazë të nevojave të tyre. Në mënyrë që pjesëmarrja e fëmijëve në vendimet e familjes të jetë e qenësishme, duhet t'i ndihmoni ata të kuptojnë pasojat e vendimeve që do të merren si dhe t'u jepni informacion të përgjithshëm mbi situatën dhe vendimet në të cilat po i përfshini. Nëse i dëgjoni fëmijët që kur janë fare të vegjël e

nëse i lejon të marrin vendime e të bëjnë zgjedhje, ata do të kuptojnë se janë të rëndësishëm, se mendimi i tyre merret në konsideratë dhe ka shumë vlerë për të rriturit. Përmes kësaj,

ata mësojnë se vendimet e tyre kanë një lloj ndikimi tek të tjerët, çka i bën edhe më të përgjegjshëm në vendimet që marrin.

Sigurisht që po aq e rëndësishme në këtë proces është prania e prindit, i cili duhet të bashkëbisedojë me fëmijën duke e mbështetur. Është e rëndësishme, gjithashtu, që t'i ndihmoni të marrin vendime të mira, fjala vjen, duke i bërë të mendojnë për pasojat e çdo vendimi që marrin.

Mos harroni. Kur prindërit marrin vendime që prekin edhe fëmijët e tyre, duhet të dëgjojnë edhe mendimin e fëmijëve, të diskutojnë me ta për vendimet e t'u shpjegojnë arsyet pse i morën këto vendime. Prindërit e kanë detyrë t'u tregojnë fëmijëve që ata janë përgjegjës për vendimet që marrin. Kjo do t'i bëjë fëmijët më të pavarur për të marrë vendime që herët për veten, vendime të përgjegjshme dhe të sigurta. Gjithsesi, duhet të kemi kujdes të mos e vendosim fëmijën në situata të vështira dhe të tregojmë që jemi aty për ta, edhe nëse ata nuk kanë marrë vendimin e duhur.

Çfarë mund të bëni ju si prindër për të mbrojtur fëmijën nga dhuna

Prindërit, mësuesit dhe personat e tjerë të familjes janë personat e parë që duhet të sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve. Prindërit dhe të rriturit e tjerë janë përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurtë, mbrojtës e të dashur në familje. Ata e kanë për detyrë të kujdesen edhe për sigurinë e fëmijëve jashtë shtëpisë, pra, në shkollë ose në lagjen ku banojnë.

Disa këshilla kyçe për t'i mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe abuzimi

Përpiquuni të jeni një model i mirë për fëmijët Fëmijët mësojnë si të sillen nga mënyra sesi ju vetë silleni me ta dhe të tjerët në familje e komunitet. Nëse i trajtoni me respekt, edhe ata do të kenë respekt për veten e të tjerët. Por, nëse jeni të dhunshëm me ta, fëmijët do të mësojnë të bëjnë të njëjtën gjë me veten dhe me të tjerët, pavarësisht se çfarë i thoni ju.

Mos përdorni dhunë për t'i mësuar se si të sillen. Këtë gjë mësojuani duke u folur dhe duke i disiplinuar.

Kontrolloni emocionet dhe sjelljet tuaja. Nëse kuptoni se po nxeheni e po humbisni toruan si dhe keni frikë se mos i dëmtoni fëmijët me fjalët apo veprimet që bëni, kërkoni që të rrijë prindi tjetër me ta sa të kalojë kjo situatë. Mos harroni se ju jeni më i fortë dhe mund t'i dëmtoni shumë edhe kur nuk doni.

Kërkoni ndihmë. Është shumë e rëndësishme për një të rritur të njohë kufijtë e tij dhe të kërkojë ndihmë kur ndihet i lodhur, i stresuar, i acaruar apo i mbytur nga problemet. Pyesni prindër të tjerë ose persona të tjerë të përshtatshëm (këshillues, mësues, njerëz dhe të afërm) se si të gjeni zgjidhje më të mira.

Mësojuni fëmijëve si t'i zgjidhin konfliktet pa dhunë

Mësojini fëmijët sesi duhet t'i trajtojnë të tjerët. Prindi e ka për detyrë t'i ndihmojë fëmijët që të mësojnë sjelljet e duhura. Bisedoni me fëmijët edhe se si duhet të jenë sjelljet e të tjerëve me ta, duke përfutur nga rasti për t'iu dhënë edhe informacion mbi prekjat e përshtatshme dhe të papërshtatshme.

Flisni me fëmijët dhe ushqejini ata me besimin për ju. Përpikuni të gjeni kohë për të biseduar me ta mbi ato që iu pëlqejnë ose që i shqetësojnë. Dëgjojin dhe nxitini të tregojnë nëse diçka po i shqetëson. Nëse kanë besim te ju, do ta kenë më të lehtë t'ju tregojnë nëse u ndodh diçka.

Mbikëqyrini dhe udhëzojini fëmijët. Sigurohuni që fëmijët e vegjël të kenë përkujdesje nga një person i besuar. Informohuni se ku janë dhe me kë janë.

Jini të vëmendshëm ndaj atyre që kërkojnë të kujdesen për fëmijët. Kini kujdes nga të panjohurit që ju bëjnë oferta të ndryshme për fëmijët, pasi këta mund edhe t'i shfrytëzojnë.

Mbrojini fëmijët nga dhuna në media dhe në internet. Mos i lejoni fëmijët të shohin dhunë në TV dhe jini të vëmendshëm ndaj përmbajtjes së gjërave që ata shohin internet.

Merrni masa në komunitet kundër dhunës së fëmijëve. Flitni me të tjerët si të parandaloni dhunën në familje; ndihmojini fëmijët e tjerë që janë viktimë të dhunës; organizoni aktivitete në komunitetin ku ndodheni, për ta ndërgjegjësuar atë kundër dhunës ndaj fëmijëve.

Raportoni dhunën ndaj fëmijëve. Nëse shikoni ose dëgjoni për dhunë ndaj fëmijëve, keni të drejtë të raportoni. Merrni në telefon në numrat 129 dhe Alo 116.

Si të rritni fëmijë me vetëvlerësim të lartë që në vitet e para të jetës

Nga ditët e para të lindjes e deri në moshën 6-vjeçare, fëmijët ndërtojnë atë që njihet si vetëvlerësim. Vetëvlerësimi është ajo çka ne besojmë për veten. Vetëvlerësimi i ndihmon fëmijët të përballen më mirë me jetën, t'i zgjidhin më mirë problemet që u dalin dhe të thonë "unë mund ta bëj" dhe "unë do ta bëj".

Që fëmija të krijojë vetëvlerësim, ka nevojë që prindërit ta duan pa kushte.

Çfarë roli ka babai te fëmija

Babai është po aq i rëndësishëm për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës sa edhe nëna. Ata kanë stile dhe pika të forta të ndryshme, por që plotësojnë njëri-tjetrin në rolet prindëruese. Përfshirja e babait në rritjen e fëmijës sjell ndikim pozitiv në mirëqenien e fëmijës dhe të familjes, sepse roli i babit është i veçantë dhe shumë i rëndësishëm.

Një baba i përgjegjshëm është i besueshëm e i pranishëm si dhe përfshihet në mënyrë aktive në

- ◆ kujdesin fizik, rutinat e ditës së fëmijës, siç janë ushqimi, gjumi apo larja
- ◆ edukimin dhe arsimimin e fëmijës në kopsht dhe shkollë
- ◆ vizitat dhe vendimet mjekësore

Babai i kujton çdo ditë fëmijët, mendon shpesh për ta dhe i mban në mendje edhe kur ndodhet larg tyre përmes

- ◆ mbajtjes së kontaktit të rregullt
- ◆ kujtimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje dhe aktivitete të rëndësishme
- ◆ njohjes dhe mbështetjes së gjërave që fëmija shfaq interes.

Një baba i kujdesshëm kalon kohë me fëmijët dhe në mënyrë aktive

- ◆ i udhëzon, i mëson, i mbështet dhe i inkurajon
- ◆ u përgjigjet si duhet, në mënyrë të vazhdueshme dhe është i ndjeshëm
- ◆ vendos kufij të arsyeshëm dhe të drejtë
- ◆ mbështet vetëbesimin dhe pavarësinë e fëmijës
- ◆ kënaqet me arritjet dhe sukseset e fëmijës.

Një baba i dashur u jep dashuri fëmijëve dhe kujdeset për ta nëpërmjet

- ◆ shfaqjes së dashurisë fizike
- ◆ qetësimi dhe ngushëllimi kur fëmijët janë të mërzitur apo të lënduar
- ◆ dëgjimit, vëzhgimit, ndjekjes dhe përgjigjes
- ◆ gëzimit të momenteve të kaluara së bashku.

Një baba aktiv dhe komunikues me fëmijët bisedon me ta e u shpreh idetë dhe emocionet nëpërmjet

- ◆ aktiviteteve të përditshme, si gatimi, blerja, pastrimi, ngrënia e vakteve së bashku
- ◆ përfshirjes në lojëra aktive dhe eksploruese
- ◆ leximit, bisedave, shakave, lojës
- ◆ mësimi të aftësive të reja
- ◆ marrjes së fëmijëve në shëtitje, librari, park lojërash etj.
- ◆ planifikimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete jashtë shtëpisë me miqtë dhe familjen, si piknik, shëtitje, peshkim, ditë festash etj.

Një baba u siguron të mira materiale dhe i mbron fëmijët nëpërmjet

- ◆ sigurimit të nevojave fizike, si ushqimi, strehimi dhe veshmbathja
- ◆ sigurimit të mjedisit të shtëpisë
- ◆ sigurimit të kujdesit dhe marrëdhënieve të shëndetshme me fëmijët/të rriturit e tjerë.

“Trupi im më përket mua” - Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimet fizike

Nëse prindërit i dëgjojnë dhe i mbështesin fëmijët, këta do të tregojnë pa problem se cilat prekje të tjerëve iu pëlqejnë dhe cilat jo. Fëmijët duhet ta dinë se atyre iu lejohet të bëjnë ç’të duan me trupin e tyre, ndërsa të tjerëve jo. “Tezja nuk ka të drejtë të më prekë e të më puthë si të dojë”, “Unë s’kam pse t’ia jap dorën kujtdo, nëse nuk më pëlqen”.

Kjo mund t’i duket e pasjellshme dikujt. Por një fëmijë që është mësuar t’i refuzojë këto prekje, do të mbrohet me më shumë vetëbesim kur dikush ta prekë fizikisht pa leje.

Të rriturit që duan të kenë kontakt fizik me fëmijën, si për shembull, mjeku apo edukatorja, duhet t’ia thonë paraprakisht fëmijës dhe ta argumentojnë qartë: “Tani duhet të të kontrolloj pak barkun” ose “Eja të të ndërroj pelenën”.

Në rastin e mjekut, disa gjëra bëhen kundër vullnetit të fëmijës, por kjo duhet përligjur qartë dhe i duhet shpjeguar fëmijës nga babai ose nëna. Por çfarë duhet të bëjë, për shembull, një edukatore kur fëmija refuzon të ndërrojë pelenën? Ta mendojë edhe një herë në mënyrë kritike të gjithë situatën. Jo të gjithë arrijnë në të njëjtin përfundim.

Disa fëmijë, të cilët, sa kohë që ishin fare të vegjël, luanin lakuriq nëpër shtëpi, vjen një çast kur fillojnë e mbyllin derën e banjës e nuk lenë njeri të hyjë. Kjo është e drejta e tyre, edhe

kur prindërit nuk e kuptojnë përse fëmija e bën këtë dhe vetë nuk kanë asnjë kompleks turpi nga të qenit lakuriq. Pjesë e respektit për personalitetin e një fëmijë është edhe respekti për autonominë e tij fizike.

Këshilla të rëndësishme për t'i mbrojtur fëmijët nga abuzimet

- ◆ Përdorni fjalët e sakta për organet e trupit dhe sidomos ato gjenitale, në mënyrë që fëmija të mund të flasë saktë për to.
- ◆ Lejojeni fëmijën të shprehë lirshëm ndjenjat e veta, si ato pozitive dhe ato negative.
- ◆ Mësojani kufijtë, por pa e frikësuar.
- ◆ Mësojani në formë loje të thotë “mjaft” kur diçka nuk i pëlqen ose nuk ndjehet mirë. Në këtë mënyrë ai do të ndalojë një tentativë për abuzim.
- ◆ Mësojani të respektojë hapësirën e vet private, por edhe atë të të tjerëve. Mos lejoni t'i preket kjo privatësi duke i kërkuar që edhe ai të respektojë hapësirën e të tjerëve.
- ◆ Mësojani të mos mbajë sekrete.
- ◆ Kini kujdes në fjetjet e tij jashtë shtëpisë tek të afërmit.
- ◆ Mos e detyroni fëmijën të jetë i mirë e i dashur me njerëzit e tjerë.
- ◆ Mos e lejoni të shkojë i pashoqëruar në banjot publike.
- ◆ Mësojani t'i pastrojë vetë organet gjenitale dhe kurrë mos ia prekni pa leje, qoftë dhe për pastrim.
- ◆ Tregoni kujdes dhe vëzhgoni sjelljen e personave që kujdesen për fëmijën, siç janë bebisiteri, edukatorja, por edhe të afërmit e prindërit.
- ◆ Vlerësoni me kujdes çdo ndryshim sjelljeje që shfaqet krejt papritur tek fëmija.

Kapitulli 5

Si duhet të komunikoni me fëmijët e vegjël

Mënyra se si ne do të komunikojmë me fëmijën, luan një rol të madh në zhvillimin e gjuhës dhe përgjithësisht në mbarë zhvillimin e tij. Fëmijës së vogël nuk i majfton që ne vetëm ta duam. Ai ka nevojë për një komunikim të vërtetë.

Çdo prind dhe i rritur duhet të përpiqet dhe të synojë që, kur të komunikojë me fëmijën e vogël, ta bëjë atë të ndjejë besim, siguri, respekt, vetëvlerësim, nxitje, zhvillim, autonomi dhe identitet.

Çfarë duhet të dijë prindi kur flet me fëmijën

Çdo prind, në mënyrë që të nxisë te fëmija sigurinë dhe pavarësinë, duhet

- ◆ të flasë, sipas rastit, me zë të ëmbël ose të prerë, por asnjëherë me zë të çjerrë dhe monoton
- ◆ të flasë ngadalë, qartë dhe t'i përsërisë fjalët
- ◆ të flasë dhe bisedojë vazhdimisht dhe me secilin fëmijë
- ◆ ta thërrasë në emër fëmijën
- ◆ t'u përgjigjet pyetjeve të fëmijës
- ◆ të komentojë lojën e fëmijës përmes fjalës
- ◆ të pasqyrojë ndjenjat që po përjeton fëmija
- ◆ të përdorë fjalë të thjeshta, të cilat i lidh me objektin për të cilin po flet
- ◆ ta inkurajojë fëmijën të flasë.

Kur komunikojmë me fëmijët e vegjël, më shumë sesa gjuha e folur, është e rëndësishme mënyra sesi përdorim trupin dhe shprehjet tona të fytyrës. Fëmija i vogël më shumë na kupton se çfarë po i themi duke lexuar lëvizjet e trupit apo të gjuhës sonë joverbale sesa nga fjalët që përdorim. Për ta bërë sa më të efektshëm komunikimin me fëmijën, çdo prind duhet

- ◆ të shihet në sy me fëmijën sa herë që flet me të
- ◆ të ulet në nivelin e gjatësisë së fëmijës kur komunikon me të
- ◆ të buzëqeshë sa më shumë kur komunikon me fëmijën
- ◆ të mos përdorë gjeste që e trembin atë
- ◆ të vishet me ngjyra të çelëta
- ◆ të japë dhe të marrë me leje lodrat fëmijës
- ◆ të shoqërojë me gjeste të thjeshta çdo fjalë.

Çfarë nuk duhet të bëni kur komunikoni me fëmijën

- ◆ Mos i jepni urdhëra!
- ◆ Mos e kërcënoni!
- ◆ Mos e gjykoni!
- ◆ Mos e fajësoni!
- ◆ Mos e kritikoni!
- ◆ Mos e shmangni!
- ◆ Mos i vini nofka!

Roli i prindit në ndërtimin e një vetëvlerësimi pozitiv të fëmijës

Vetëvlerësimi ndërtohet përmes marrëdhënieve cilësore mes fëmijëve dhe atyre që janë të rëndësishëm në jetën e tyre. Pjesën më të madhe të kohës fëmijët kërkojnë të gjejnë tek ju një refleksim të asaj se kush dhe si janë. Si vëzhgues të zotë, ata kapin cdo informacion që i jepni përmes fjalëve, shprehjes së fytyrës, lëvizjeve të trupit, tonit të zërit, prekjes. Ata e vënë re se si përgjigjemi dhe reagojmë me ta, nëse i plotësohen nevojat fizike dhe emocionale, nëse merren seriozisht dhe dëgjohen nga ne, nëse respektohen dhe kënaqen. Ata vëzhgojnë dhe më pas arrijnë në konkluzione të tilla, si “Unë jam i rëndësishëm”, “Mua më duan”, “Jam kot”. Konkluzionet e tyre bëhen të vërtetat e tyre, bindjet e tyre themelore lidhur me atë se kush janë dhe çfarë meritojnë në jetë. Fëmijët tentojnë t'i shohin sidomos prindërit si të plotfuqishëm e të gjithëdijsëm. Ata mendojnë se “Këta njerëz të rëndësishëm më trajtojnë siç e meritoj. Ato që thonë për mua, janë të vërteta.” Kur ata respektohen, arrijnë në konkluzionin

se e meritojnë respektin, duke zhvilluar kështu vetërespektin. Kur ata trajtohen me vlerësim, arrijnë në konkluzionin se e meritojnë vlerësimin, duke zhvilluar kështu vetëvlerësimin.

E vërteta është se asnjë fëmijë nuk e meriton të abuzohet dhe të ndëshkohet. Çdo fëmijë meriton dhe ka nevojë për respekt dhe dashuri të pakushtëzuar. Është detyra juaj që t'ia përmbushni këto nevoja.

Vetëvlerësimi pozitiv varet nga dashuria pa kushte; dashuri me respekt, pranim, vlerësim, empati, ndjeshmëri dhe ngrohtësi; dashuri që thotë se “unë të dua dhe të pranoj ashtu siç je.”

Ndërkohë, dashuria me kushte “fiket” dhe “ndizet” sipas rastit. Ajo e manipulon sjelljen duke thënë, “unë të dua kur _____, sepse _____, apo nëse bën diçka.” Fëmijët që marrin dashuri me kushte, nuk e ndiejnë kurrë se i duan. Edhe kur ata marrin dashuri, nuk mund t'i besojnë asaj. Këta fëmijë përpiqen ta fitojnë dashurinë duke u bërë njerëz që i “bëjnë të tjerët për vete”. Sfida juaj është t'i lejoni dhe t'i inkurajoni fëmijët të jenë vetëvetja ndërsa i udhëzoni, i mbështesni dhe festoni procesin e rritjes së tyre.

Prindërit e suksesshëm jo vetëm i duan pa kushte, por edhe i mbrojnë, u vendosin kufij dhe u japin përgjegjësi në përshtatje me moshën dhe zhvillimin e tyre. Kjo dashuri e qëndrueshme është thelbësore e mbrojtëse edhe në momentet më të vështira për fëmijën.



Kapitulli 6

“Detyra jonë nuk është që të ngulisim impulse vetëmbrojtëse dhe agresive te fëmija, por ta ndihmojmë të mësojë që t’i kanalizojë këto impulse drejt një sjelljeje të pranueshme”

Si mund t’i disiplinoni fëmijët e vegjël

Çfarë është disiplina

Disiplina është procesi që e udhëzon fëmijën se cilat janë sjelljet e pranueshme dhe të papranueshme. Disiplina nuk ka aspak lidhje me ndëshkimin e fëmijës dhe nuk përmban sjellje të tilla prindërore, si t’i vësh në dukje fëmijës dështimet, të bëhesh i keq me të apo ta bësh të ndihet keq për veten. Synimi i disiplinës është t’i japë fëmijës bazën e nevojshme për të jetuar një jetë më të mirë kur të rritet. Disiplinimi i fëmijës është detyrë kryesore e prindërve, prandaj është e rëndësishme që çdo prind të ketë disa njohuri bazë mbi këtë.

Disiplina dhe ndëshkimi, a janë e njëjta gjë

Shumë të rritur mendojnë se disiplina dhe ndëshkimi janë e njëjta gjë. Por, siç mund ta shihni edhe në tabelën e mëposhtme, ato janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Disiplina mund të konsiderohet si një sistem mësimi i bazuar në marrëdhënien e mirë, vlerësimin dhe instruktimin për vetëkontroll. Disiplina efektive është proces, kërkon kohë dhe ndodh ditë pas dite, kurse ndëshkimi përcjell mesazhe negative, pasi ai është rrjedhoja e pakëndshme kur fëmija nuk bën atë që i kërkohet ose bën diçka të ndaluar. Turpi dhe sikleti nuk janë elemente të disiplinës pozitive. Fëmija ka më shumë gjasa ta ndryshojë sjelljen kur ndihet i mbështetur dhe i vlerësuar.

Disiplina	Ndëshkimi
thekson se çfarë duhet të bëjë fëmija	thekson se çfarë nuk duhet të bëjë fëmija
është një proces i vazhdueshëm	shfaqet me raste
krijon një model	ushqen bindjen dhe përuljen
çon në vetëkontroll	dëmton pavarësinë
i ndihmon fëmijët të ndryshojnë	është një zgjidhje nga i rrituri
është pozitive	është negative
pranon autonominë e fëmijës	fëmija silltet siç do i rrituri
nxit aftësinë e fëmijës për të menduar	Mendon i rrituri për fëmijën
rrit vetëvlerësimin	ul vetëvlerësimin
formëson sjelljen	dënon sjelljen e gabuar

7 bindje të gabuara të prindërve mbi ndëshkimin e fëmijës

Bindja nr. 1

"Edhe mua më ka ndodhur (p.sh. të më rrahin) e prapë s'më ka gjetur gjë"

Bindja nr. 2

"Vetë e kërkojnë"

Bindja nr. 3

"Ndëshkimi fizik funksionon më mirë se metodat e tjera"

Bindja nr. 4

"Ndëshkimi fizik i mëson të binden"

Bindja nr. 5

"Unë e përdor, po vetëm si mjet të fundit"

Bindja nr. 6 "Është e vetmja mënyrë se si t'i mbaj nën kontroll gjithë ata fëmijë që kam"

Bindja nr. 7

"Ndëshkimi fizik është pjesë e kulturës sonë"

Disa argumente për ndalimin e ndëshkimit fizik dhe psikologjik

- ◆ Ndëshkimi fizik dhe ai psikologjik dhunon të drejtën e fëmijës për t'u respektuar, për integritet fizik dhe dinjitet njerëzor.
- ◆ Ndëshkimi fizik dhe ai psikologjik kanë një veprim të dëmshëm në zhvillimin e fëmijës duke sjellë pasoja sociale, emocionale dhe fizike tek ata.
- ◆ Ndëshkimi fizik dhe ai psikologjik u mësojnë fëmijëve se dhuna është një metodë e drejtë për zgjidhjen e konflikteve. Ato, po ashtu, legjitimojnë abuzimin me pushtetin si një pjesë thelbësore e raporteve afektive.
- ◆ Mbi të gjitha, ndëshkimi fizik dhe ai psikologjik janë kaq të përhapura sa që i shkurajojnë mësuesit dhe prindërit për të provuar alternativa të tjera.
- ◆ Ndëshkimi fizik dhe ai psikologjik mund të jenë shkak i lënies së shkollës, i rezultateve të dobëta në mësim, i komunikimit jo të mirë dhe i vetëvlerësimit të ulët të fëmijëve.

Parime kyçe të disiplinimit

1. Fëmijët duan që kufijtë t'u vihen nga të rriturit.
2. Të rriturit duhet ta shohin disiplinimin si mësim, jo si ndëshkim.
3. Të rriturit duhet të ruajnë qetësinë kur disiplinojnë fëmijën.
4. Të rriturit duhet të jenë korrektë dhe të qëndrueshëm në disiplinimin e fëmijës.
5. Të rriturit duhet t'i vendosin pritshmëritë në përputhje me moshën e fëmijës.

Pesë fakte që duhet të dijë çdo prind

1. E gjithë sjellja është një formë komunikimi

2. Ka gjithmonë një arsye pse fëmija shfaq sjellje problematike

- për të kërkuar vëmendje apo diçka që do
- për t'u shpëtuar aktivitetëve apo detyrave

3. Mund të ketë arsye të ndryshme që qëndrojnë pas një sjelljeje të fëmijës

- mund të jetë i uritur, i lodhur, i lënduar, i frikësuar, i mërzhitur, i zemëruar etj.
- mund të ndihet mirë kur shtyn apo tërheq, fjala vjen, lodra apo objekte të tjera
- mund të ndihet jashtë kontrolli dhe po përpiqet ta rifitojë atë

4. Prindërit mund të mësojnë se si ta kuptojnë dhe ta interpretojnë sjelljen problematike të fëmijës

- Fëmijët kanë nevojë për një person të besueshëm dhe të dashur që t'i ndihmojë të mësojnë si të përballen në një botë ku konflikti është pjesë e jetës.
- Është e rëndësishme të gjejmë kuptimin e sjelljes së fëmijës.

5. Sjellja problematike e fëmijës mund të përballohet me mbështetje, jo me ndëshkim

- Kur fëmijët ndihen të respektuar dhe iu përmbushen nevojat, ata kanë prirjen të mos e përdorin sjelljen problematike si formë komunikimi.
- Kur prindërit i ndihmojnë fëmijët të gjejnë rrugët e duhura për të komunikuar nevojat e tyre, këta aftësohen për t'i zgjidhur problemet, çka do t'i ndihmojë shumë gjatë gjithë jetës.

Stilet e prindërimit

Prindërit janë të ndryshëm në mënyrën se si sillen me fëmijët dhe nga mënyra se si përpiqen t'i dispijlojnë ata. Studimet thonë se ka katër lloje apo stile prindërimi.

Prindi autoritar. Në këtë stil prindërimi, prindi pret nga fëmija që ky të ndjekë në mënyrë strikte të gjitha rregullat e vendosura prej tij. Nëse fëmija dështon në zbatimin e rregullave, ai ndëshkohet. Këta prindër nuk u shpjegojnë fëmijëve arsyet e vendosjes së rregullave. Edhe nëse pyeten nga fëmija, ata thonë "sepse kështu them unë". Këta prindër kanë shumë kërkesa, por nuk iu përgjigjen nevojave të fëmijëve.

Prindi me autoritet. Prindërit që i takojnë këtij stili prindërimi vendosin rregulla dhe udhëzime, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin. Ky stil prindërimi është më demokratik. Prindërit me autoritet u përgjigjen nevojave të fëmijëve dhe dëgjojnë pyetjet e tyre. Kur këta nuk arrijnë pritshmëritë e duhura, prindërit tregojnë më shumë përkujdesje dhe falin më shumë. Këta prindër monitorojnë dhe vendosin standarde të qarta për sjelljen e fëmijëve të tyre. Ata janë kërkuar, por jo bezdisës dhe ndëshkues. Metodat e tyre të disiplinës janë mbështetëse, jo ndëshkuese. Ata duan që fëmijët e tyre të jenë të përgjegjshëm, bashkëpunues dhe të ekuilibruar.

Prindi lejues. Prindërit lejues kanë shumë pak kërkesa ndaj fëmijëve të tyre dhe shumë rrallë i dispijlojnë ata. Këta prindër u japin shumë fëmijëve, por u kërkojnë pak. Ata nuk kërkojnë nga fëmijët sjellje të pjekur e të përgjegjshme, madje shmangin edhe përballjet me ta. Ata janë të kujdesshëm dhe komunikues me fëmijët duke u bërë më shumë shokë se prindër me ta.

Prindi i paangazhuar. Stili i paangazhuar i prindërimit karakterizohet nga pak kërkesa, pak përgjigje ndaj nevojave të fëmijës dhe pak komunikim. Edhe pse këta prindër përmbushin nevojat bazë të fëmijëve, ata në përgjithësi nuk janë të lidhur me jetën e fëmijëve të tyre. Në raste të caktuara, këta prindër mund të refuzojnë ose të neglizhojnë nevojat e fëmijëve.

Si ndikon stili i prindërimit te fëmijët

Të gjithë duam atë që është më e mira për fëmijët. Nga pikëpamja e zhvillimit të njeriut, fëmijëria e hershme konsiderohet një periudhë e rëndësishme. Shpesh prindërit nuk e kuptojnë se si zgjedhjet dhe stili i prindërimit mund të ndikojnë në sjelljen dhe zhvillimin e mëtejshëm të fëmijës. Kjo nuk duhet t'ju frikësojë, po, përkundrazi, t'ju ndihmojë që ta bëni fëmijën një njeri edhe më të mirë në jetë. Përderisa zgjedhje të ndryshme prindërimi japin ndikime të ndryshme në zhvillimin e fëmijës, ju mund të shihni se çfarë fëmijësh formon secili nga stilet e prindërimit.

Stili autoritar shpesh formon fëmijë të bindur dhe të suksesshëm, por këta fëmijë janë më pak të lumtur dhe kanë probleme me kompetencën sociale e vetëvlerësimin.

Stili me autoritet formon fëmijë të lumtur, të aftë e të suksesshëm.

Stili lejues shpesh formon fëmijë që nuk janë të lumtur dhe me probleme në sjellje. Këta fëmijë kanë probleme me figurat autoritare dhe rezultate të dobëta në shkollë.

Stili i paangazhuar “nxjerr” fëmijë me shumë probleme në të gjitha fushat. Këta fëmijë nuk kanë vetëkontroll, kanë vetëvlerësim të ulët dhe janë më pak kompetentë se bashkëmoshatarët.

Shtatë sugjerime për të praktikuar disiplinën

1. Përpquni të kuptoni rëndësinë e sjelljes.
2. Përpquni që të kontrolloni veten, jo fëmijën.
3. Kini pritshmëri të qëndrueshme ndaj sjelljes së fëmijës.
4. Vini në dukje ato sjellje të fëmijës që ju pëlqejnë, jo ato që nuk ju pëlqejnë.
5. Tregojuni fëmijëve se çfarë duhet, jo çfarë nuk duhet të bëjnë.
6. Kanalizojeni energjinë e tyre në lojëra dhe aktivitete të ndryshme.
7. Mos kërkonit dëmshpërblim ose shpërblim nga fëmija.

Kur prindërit pyesin se si mund ta kuptojnë nëse janë shumë të rreptë me fëmijën e tyre, iu sugjerojmë të vëzhgojnë me kujdes:

- ◆ nëse fëmija është shumë i mirë (i mbarë) apo shumë i urtë
- ◆ nëse fëmija është shumë i ndjeshëm, madje edhe ndaj kritikës më të vogël
- ◆ nëse fëmija nuk i teston kufijtë në mënyra të përshtatshme me moshën e tij
- ◆ nëse fëmija nuk ka ndjenjën e humorit dhe nuk shfaq gëzim
- ◆ nëse fëmija është i irrituar ose shpreh ankth pjesën më të madhe të kohës
- ◆ nëse fëmija shfaq shenja tensioni në ushqyerje, në gjumë ose në daljen jashtë dhe i ndodh që t'i kthehet sjelljeve tipike për fëmijët më të vegjël.

Secila nga simptomat e mësipërme është një sinjal për prindërit, që u tregon se duhet riparë me vëmendje mënyra se si e kanë disiplinuar fëmijën.

Disa këshilla të fundit për disiplinimin e fëmijëve

- ◆ Respektoni fazën e zhvillimit të fëmijës.
- ◆ Përshtateni disiplinimin me gjendjen e zhvillimit të fëmijës. Për fëmijën deri në dy vjeç përpiquni ta kaloni vëmendjen e tij në një tjetër lojë apo aktivitet. Nëse kjo mënyrë nuk funksionon, mundohuni ta largoni vetë nga vendi ku ndodhet. Për fëmijën mbi dy vjeç, disiplinimi duhet të përfshijë gjithnjë shpjegimin e arsyeve pse po e disiplinoni. Përpiquni të zbuloni se çfarë e nxit agresivitetin apo sjelljen e papërshtatshme të fëmijës dhe jepini mundësi që ta kuptojë vetë këtë gjë.
- ◆ Disiplina duhet të jetë në përshtatje me natyrën e fëmijës. Ju e njihni temperamentin dhe gjërat që e prekin fëmijën tuaj. Një fëmijë i ndjeshëm kërkon një mënyrë tjetër disiplinimi nga një fëmijë aktiv dhe kokëfortë.
- ◆ Kur fëmija juaj luan me fëmijë të tjerë, përpiquni që të mos i qëndroni gjatë mbi kokë.
- ◆ Ofroni modele sjelljeje për fëmijën. Mënyra se si e ndihmoni të zgjidhë një konflikt, është shumë më efektive dhe instruktuese sesa shumë e shumë fjalë.
- ◆ Kërkojini fëmijës të japë mendimin e tij për atë se çfarë do ta ndihmonte herë tjetër si mënyrë për ta disiplinuar.
- ◆ Ndëshkimi fizik ka disavantazhe të mëdha.
- ◆ Ndaluni dhe rivlerësojeni situatën, nëse disiplinimi nuk po vepron.

Kur duhet të kërkonti ndihmë

Nëse konstatooni një a më shumë nga sa përmendet më poshtë, duhet të kërkonti menjëherë ndihmë profesionale. Sa më shpejt të kapen këto probleme, aq më mirë është për fëmijën dhe për ju vetë:

- ◆ mungesë respekti për të gjitha figurat autoritare: prindërit, mësuesit e të rriturit e tjerë
- ◆ sjellje agresive dhe shkatërruese
- ◆ marrëdhënie të caktuara në familje, që janë të vështira për fëmijën
- ◆ ndjenja të forta izolimi dhe/ose refuzimi
- ◆ ndjenja se po kapen/ngacmohen me të ose po e persekutojnë
- ◆ shprehje të dhunës së fortë në punimet artistike, në komunikimin a lojën me të tjerët
- ◆ zemërim i pakontrolluar
- ◆ sjellje kronike impulsive, dhune, ngacmuese dhe përfshirje në situata bulizmi



Kapitulli 7

Si formohet te fëmijët koncepti i gjinisë

Identiteti gjinor dhe rolet gjinore në fëmijërinë e hershme

Që nga momenti që prindërit dëgjojnë fjalën “është djalë” apo “është vajzë”, ata kanë një ide të qartë se si do të sillet fëmija i tyre, çfarë do të veshë e mbase se cila do të jetë karriera e tij. Por, sipas studimeve, krijimi i identitetit gjinor bazohet në një numër të madh faktorësh që zhvillohen kryesisht në vitet e fëmijërisë së hershme.

Sipas studimeve, identiteti gjinor, pra, që fëmija të ndjejë se është djalë apo vajzë, fillon që nga mosha 8 – 10-muajshe. Gjatë vitit të dytë, fëmijët e vegjël mund të dallojnë se ka ndryshime fizike mes djemve dhe vajzave. Kur mbushin 3 vjeç, ata mund të thonë nëse janë vajza apo djem dhe, kur bëhen 4 vjeç, kuptojnë që identiteti i tyre gjinor është i pandryshueshëm, pra, që do të jenë djem apo vajza për një kohë të gjatë. (përhershmëria e gjinisë)

Stereotipet gjinore në lojë

Kur fëmija është në moshën 3-vjeçare, ai mund të identifikojë se cilat lodra janë për djem (makinat, për shembull) dhe cilat për vajza (p.sh. kukullat). Fëmija e di edhe se cilat aktivitete janë më shumë për vajzat dhe cilat për djemtë. Gjatë viteve të ciklit fillor fëmijët nisin të pëlqejnë lojërat me fëmijët e gjinisë së vet e të mos pëlqejnë lojërat me gjininë e kundërt.



Si ndikojnë prindërit në identitetin gjinor të fëmijëve

Identiteti gjinor përkufizohet si imazhi që ne ndërtojmë për veten si individ me karakteristika mashkullore ose femërore. Ndërgjegjësimi i fëmijës për veten formohet kryesisht nga ekspozimi që ai ka ndaj përvojave, bindjeve, qëndrimeve dhe sjelljeve, të cilat, në të shumtën e rasteve, sigurohen nga prindërit në vitet e fëmijërisë

së hershme. Shpesh prindërit i nxisin fëmijët të luajnë me lodra tipike për gjininë e tyre e të marrin pjesë në aktivitete tipike për atë gjini. Kur fëmijët rriten, atyre mund t'u kërkohej nga prindërit të bëjnë detyra dhe punë që lidhen ngushtë me gjininë së cilës i përkasin.

Prindërit i shohin dhe i trajtojnë djemtë dhe vajzat në mënyra të ndryshme, ndaj dhe mësimi tradicional sipas roleve gjinore është shumë i rëndësishëm të kapërcehet si nga prindërit ashtu dhe nga media e i gjithë mjedisi shoqëror.



Çfarë mund të bëjnë prindërit

Siguroni një mjedis që i mundëson fëmijës të eksplorojë role gjinore të ndryshme dhe tipe lojërash të ndryshme.

- ◆ Librat e fëmijëve ose pazëllat të tregojnë burra dhe gra në role jostereotipike (p.sh. police femra, edukatorë meshkuj etj.)
- ◆ Përdorimi i lodrave të larmishme
- ◆ Lejimi i fëmijëve që të merren me sporte dhe aktivitete të ndryshme, të cilat nuk lidhen me gjininë e tyre (p.sh. vajzat të luajnë futboll)

Ndryshimet gjinore në zhvillimin e hershëm të trurit

Truri i meshkujve dhe i femrave nuk funksionon në të njëjtën mënyrë. Në përgjithësi truri i meshkujve është pak më i madh se i femrave. Djemtë përdorin dy hemisferat e trurit në mënyrë më të pavarur në detyra të tilla mendore, si eksplorimi i mjedisit apo i të folurit. Për të njëjtat detyra, femrat i përdorin të dyja hemisferat në mënyrë të njëjtë.

Nga ana tjetër, në shumicën e aftësive njohëse dhe shqisore vajzat janë pak më të zhvilluara se djemtë: shikimi, kujtesa, dëgjimi, nuhatja, prekja janë më të zhvilluara te foshnjat femra. Ato janë më sociale, reagojnë më shpejt ndaj zërit dhe fytyrës së prindit. Vajzat janë më të përparuara edhe në aftësitë e motorikës fine dhe aftësive gjuhësore. Vetëm në moshën 3-vjeçare djemtë ua kalojnë vajzave në integrimin e aftësive vizualo-hapësinore. Ndërkohë vajzat janë më të zhvilluara në aftësi verbale, si p.sh. në njohjen dhe identifikimin e shprehjes së ndjenjave në fytyrën e dikujt. Sigurisht që ka vajza me aftësi shumë të mira orientimi në hapësirë siç ka edhe djem me aftësi të mira verbale.

Këto ndryshime mes djemve dhe vajzave duhen parë nga prindërit si një mundësi që të punojnë me fëmijët për të kompensuar ato prirje që janë të ndryshme nga njëra gjini në tjetrën. Kështu, nëse u japim mundësi djemve të kryejnë aktivitete dhe lojëra që zhvillojnë aftësitë e tyre verbale, përmes bisedave dhe lojërave me fjalë ata mund ta përmirësojnë këtë aftësi.

Pse është e rëndësishme që si djemtë, edhe vajzat të ndjekin kopshtin dhe shkollën

Sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijëve është e rëndësishme që fëmijët të kenë mundësi të arsimohen e të ndjekin kopshtin dhe shkollën pavarësisht nëse janë djem apo vajza. Me fjalë të tjera, çdo fëmijë ka të drejtë të zhvillojë potencialin e vet, pavarësisht gjinisë.

Shumë studime tregojnë se shkollimi i hershëm i vajzave sjell përfitime të shumta jo vetëm për to, por për të gjithë familjen dhe shoqërinë. Sa më shumë të shkollohen vajzat, aq më shumë kujdes do të kenë ato për shëndetin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre. Sipas disa studimeve, çdo vit shkollor që ndjek nëna, është i lidhur ngushtë me uljen e përqindjes së vdekjes së foshnjave të saj. Kështu, duke u dhënë mundësi vajzave të shkollohen herët, rriten mundësitë e mbijetesës së fëmijëve në komunitet. Familjet ku nënat janë të shkolluara, në përgjithësi kanë më shumë të ardhura sesa ato ku i shkolluar është vetëm babai. Ndikimi që ka në shoqëri arsimimi i femrave, është i jashtëzakonshëm, prandaj ka shumë rëndësi që çdo prind të nxisë dhe të mbështesë në një moshë sa më të hershme arsimimin dhe shkollimin e vajzave pa asnjë dallim nga djemtë.

Kapitulli 8

Pse është i rëndësishëm partneriteti kopsht - familje

*NËSE I JEPNI FËMIJËS NJË PESHK, I SIGURONI USHQIMIN PËR NJË DITË.
NËSE E MËSONI SI TË PESHKOJË, I KENI SIGURUAR USHQIM PËR TËRË JETËN.*
(Proverb kinez)

Çfarë duhet të dijë prindi për veprimtarinë mësimore-edukative që zhvillohet në kopsht

Partneriteti kopsht-familje është shumë i rëndësishëm për mirërritjen, kujdesin dhe edukimin e fëmijëve. Bashkëpunimi mësues-prind, është vlerësuar gjithmonë si kyçi i suksesit të fëmijës, sidomos kur ai/ajo është në moshën parashkollore.

Bashkëpunimi kopsht-familje është efektiv, kur ai mbështetet në besimin dhe në respektin reciprok të të dyja palëve dhe në bashkëndarjen e përgjegjësisë për edukimin cilësor të fëmijës. Prindërit përfaqësohen me disa organizma, brenda institucioneve parashkollore, si: këshilli i prindërve të klasës, këshilli i prindërve të kopshtit dhe Bordi i kopshtit. Nëpërmjet këtyre organizmave, çdo prind merr informacion në lidhje me programin që zhvillon kopshti, regjimin ditor, aktivitetet që zhvillohen, si dhe me veprimtaritë që mund të kryhen në shtëpi për të plotësuar dhe përforcuar punën e njëri-tjetrit.

Çfarë duhet të dijë prindi më shumë

- ◆ Prindi dhe stafi pedagogjik shkëmbejnë çdo ditë informacione me njëri-tjetrin.
- ◆ Prindërit janë të mirëpritur në të gjitha momentet e ditës në kopsht.
- ◆ Prindërit janë pjesë e vendimeve që kanë lidhje me veprimtarinë e kopshtit.
- ◆ Prindërit informohen nga stafi pedagogjik rreth programit të edukimit të kopshtit.
- ◆ Prindërit duhet të jenë të informuar për standardet e parashkollorit.

- ◆ Prindërit i japin stafit pedagogjik sugjerime për aktivitetet që do të zhvillojnë në grup apo në kopsht.
- ◆ Stafi pedagogjik bashkëpunon me prindërit, në mënyrë që aktivitetet që zhvillohen në kopsht dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëri-tjetrin.

Regjimi ditor në kopsht - Alternimi i veprimtarive të qeta me veprimtaritë aktive

Fëmija konsiderohet si aktori kryesor i zhvillimit të vet, i aftë të ndërveprojë me të rriturit dhe bashkëmoshatarët, proces ky që është shumë i rëndësishëm për të.



I rrituri dhe fëmija ndërtojnë modele sjelljesh, dialogojnë dhe komunikojnë duke i dhënë kuptim veprimeve dhe ngjarjeve, dhe krijojnë sistemin e tyre të bashkëveprimit.

Në këtë proces, fëmija përballet me strukturat e të kuptuarit, të të menduarit të vlerave shoqërore dhe kulturore që të gjitha së bashku ndikojnë në procesin e formimit dhe njohjes së tij.

Në këtë mënyrë, fëmija integrohet në mjedisin shoqëror dhe kulturor të shoqërisë që i përket nëpërmjet procesit të nxënies, të kuptuarit dhe të ushtruarit të njohurive që merr për realitetin

fizik dhe social.

Ritmet e organizimit ditor përfshijnë tërësinë e momenteve të çlodhjes, të argëtimit, të rigrupimit të fëmijëve, në funksion të realizimit të veprimtarisë edukative, të përmbushjes së nevojave individuale të fëmijëve, të momenteve të bashkëveprimit midis fëmijëve të moshave të ndryshme etj. Të gjitha këto modifikojnë ose pasurojnë veprimtarinë mësimore-edukative në përputhje me regjimin ditor dhe duke bërë të mundur që fëmija gradualisht të ndërgjegjësohet për kohën që ka në dispozicion, mjedisin dhe arsyen e zhvillimit të veprimtarisë.

Organizimi dhe shfrytëzimi i kohës për realizimin e veprimtarisë mësimore-edukative

Në veprimtaritë ditore respektohen rregullat e alternimit të veprimtarive dhe të kombinimit të tyre.

Mësuesja në kopsht :

- ◆ zhvillon aktivitete bazuar në standardet e parashkollorit në mënyrë që fëmija të zhvillohet në mënyrë holistike;
- ◆ zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: në grup të madh; në grup të vogël dhe individuale;
- ◆ zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: të lira; të sugjeruara dhe të drejtuara;
- ◆ zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, në ato që kërkojnë përqendrim, vëmendje apo çlodhëse;
- ◆ zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, që zhvillohen në mjedise të ndryshme (ulur, në këmbë, në pozicion çlodhës, në të njëjtin vend apo në

vende të ndryshme); në një mjedis tjetër të kopshtit, brenda apo jashtë kopshtit;

- ♦ zhvillon forma dhe lloje të ndryshme veprimtarie të alternuara, si: të udhëhequra nga mësuesja e grupit apo të udhëhequra nga një person tjetër (prindi);
- ♦ zbaton kohëzgjatjen e veprimtarive duke sugjeruar përdorimin e këndeve dhe lodrave, në funksion të moshës së fëmijëve, zbaton veprimtari individuale të vëzhgueshme, duke dalluar shenjat e dukshme të lodhjes, të mungesës së interesit; zbehje, gogësima, shtriqje etj.

Në kopsht respektohen nevojat biologjike, emocionale dhe sociale të fëmijëve. Kjo do të thotë që mësuesja zhvillon veprimtari për dhënien e njohurive të reja që kërkojnë përqendrim të vëmendjes dhe të kujtesës. Njohuritë e reja dhe konceptet janë rrjedhojë e veprimtarive/eksperimenteve/vëzhgimeve të vazhdueshme, duke e finalizuar informacionin e ri kryesisht në fund të javës, në fund të dy javëve apo në fund të muajit.

Marrja e informacionit nga ana e prindit për alternimin e veprimtarive dhe organizimin e kohës së fëmijës parashkollor është i rëndësishëm për fëmijën dhe për kohën që ai kalon pranë familjes.

Regjimi ditor dhe respektimi i ritmeve në një mjedis nxitës dhe bashkëveprues

Në kapitujt e mëparshëm është folur për rëndësinë që ka organizimi i mjedisit fizik. Edhe në kopsht, stafi pedagogjik organizon një mjedis të përshtatshëm emocional dhe afektiv, duke i ofruar fëmijëve rehati, çlodhje, mjedis pa zhurmë, temperaturë të përshtatshme të mjedisit, zgjedhje personale e vendit nga vet fëmija apo praninë e një sendi apo lodre familjare për fëmijën.

Mjetet, lodrat dhe materiale të riciklueshme përzgjidhen të tilla që janë në përshtatje me moshën dhe prirjet e fëmijëve, nxisin zhvillimin dhe të shprehurit krijues të fëmijëve.

Në zhvillimin e veprimtarive mësimore respektohen marrëdhëniet e sistemimit, mjedisit dhe kohës

Në kopsht shfrytëzohen hapësirat e përcaktuara për veprimtarinë mësimore-edukative, si oborri i kopshtit, për veprimtari të ndryshme fizike mësimore edukative, lojëra të ndryshme që lidhen me veprimtari të organizuara dhe të lira në dobi të veprimtarisë mësimore edukative.

Në përgjithësi, mjedisi i klasës është i organizuar në bazë të qendrave të veprimtarisë dhe pasurohet vazhdimisht me mjete dhe materiale të ndryshme.

Veprimtaritë mësimore-edukative orientohen sipas standardeve dhe programeve të arsimit parashkollor

Veprimtaria mësimore-edukative në kopsht zhvillohet në përputhje me dokumentacionin shkollor dhe realizohet nëpërmjet veprimtarive të planifikuara nga mësuesja.

Çdo ditë, në takimin e mëngjesit, mësuesja bisedon dhe u tregon fëmijëve çfarë do të bëjnë gjatë ditës, plotëson bashkë me fëmijët kalendarin ditor dhe kalendarin e motit, zbaton veprimtari të organizuara në qendrat e aktiviteteve të tilla, si: veprimtari grafike, artistike, shkencore në fusha të ndryshme, veprimtari vëzhguese, veprimtari të organizuara për zhvillimin e të folurit, të shkruarit, lojëra didaktike etj., drejton dhe lehtëson bashkëbisedimin midis fëmijëve.

Mësuesja nxit fëmijët të marrin pjesë në veprimtari manipulative, të bashkëveprojnë me bashkëmoshatarët dhe me më të rriturit, zhvillon lojëra duke u lejuar fëmijëve kohë dhe hapësira të mjaftueshme, siguron objekte teatrale për lojërat e pretenduara, i zhvillon veprimtaritë mësimore-edukative me materiale mbështetëse, tregon ose aktron histori të cilat janë familjare për fëmijët në mënyrë që ata ta "ritregojnë" vetë historinë, siguron një mjedis të pajisur mirë për lojën me kukulla, figura njerëzish dhe kafshësh, pranë këndit të caktuar etj.

Krahas tyre, mësuesja parashikon veprimtari lëvizëse në planifikimin e veprimtarive ditore, përdor muzikën dhe këngën në planin dhe veprimtaritë ditore, siguron vegla dhe instrumente të ndryshme, në mënyrë që fëmijët të luajnë, organizon lojëra ritmike, p.sh.: duke trokitur duart etj., u krijon kohë dhe hapësirë të mjaftueshme fëmijëve, të ndërtojnë me materiale të ndryshme, po aq sa dhe të bëjnë punime artistike.

Çdo ditë me fëmijët organizohet "koha e librit", gjatë të cilës fëmijët nxjerrin librat që duhen lexuar apo duhen marrë në shtëpi. Ajo siguron materiale me shenja për t'i eksploruar dhe ndërvepruar, u mëson fëmijëve vjersha, duke ua përsëritur me zë të lartë, luan bashkë me fëmijët lojëra me tinguj të ndryshëm, në mënyrë që të mësohen për të identifikuar tingujt etj. Veprimtaritë që zhvillohen në kopsht janë lehtësisht të mundura të kryhen edhe në shtëpi. Për aktivitete dhe lojëra, për të cilat fëmija është i interesuar, në familje është koha më e përshtatshme me të cilat ai mund të merret.

Çfarë mund të bëjë prindi në shtëpi për të vijuar punën e bërë në kopsht

- ◆ Në tema të ndryshme mësimore, flitet për higjienën e gojës, të duarve, të fytyrës dhe të trupit. Prindi duhet ta ndihmojë fëmijën t'i zbatojë çdo ditë. Mundësisht 1 herë në 6 muaj duhet bërë kontrolli i gojës së fëmijës te dentisti.
- ◆ Në moshën parashkollore fëmija zotëron dhe kontrollon shumë mirë si lëvizjet, dhe ekuilibrin. Fëmija ka një imagjinatë dhe fantazi të zhvilluar dhe i pëlqen të bëjë aventura. Kjo mund t'abëjë fëmijën pre të aksidenteve të shumta, prandaj prindi duhet ta mbajë fëmijën në vëzhgim të përhershëm.
- ◆ Fëmija parashkollor është kureshtar dhe ka interes të mësojë gjithçka. Kjo është arsyeja që ata drejtojnë shumë pyetje, por edhe mund të tentojnë të japin përgjigje shtu siç e mendojnë.
- ◆ Gjatë kësaj moshë, fëmija mund të njohë zhvillime të reja nga frika, sidomos nga gjërat që i sheh për herë të parë dhe tingujt e panjohur. Fëmija mëson si të japë e të marrë me të tjerët pjesën më të madhe të kohës. Pjesë normale në zhvillimin e fëmijës në këtë moshë është eksplorimi seksual i vetes së tij. Prandaj prindi duhet të jetë i parapërgatitur për çdo mesazh që jep apo veprim që kryen fëmija.
- ◆ Të zhillojë aktivitete ku fëmija mund të mësojë mbi sferën emocionale dhe se si të mund të menaxhojë emocionet e tij.

Kapitulli 9

Të nxënë të nëpërmjet lojës

Loja dhe rëndësia e saj për fëmijën parashkollor

Në çdo mjedis ku ndodhet, fëmija luan, me një lodër apo me një send, që shpeshherë për të rriturit ngjall habi dhe kuriozitet sesi ai/ajo kalon orë të tëra pa u mërzhitur. “Lojë” mund të quhet çdo aktivitet spontan i cili është argëtues. Loja për fëmijën është po aq e rëndësishme sa puna për të rriturin. Fëmijët përfitojnë shumë kur kanë një kombinim midis aktiviteteve të planifikuara dhe drejtuara nga të rriturit dhe aktiviteteve që planifikohen dhe drejtohen nga vetë ata. Pra, loja është veprimtaria më e rëndësishme në jetën e fëmijëve.



Gjatë lojës, fëmijët eksplorojnë mjedisin rreth tyre, mësojnë duke punuar dhe krijojnë lidhje me të. Ata mund t'i shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre nëpërmjet lojës më lehtë sesa t'i shprehin me fjalë. Nëpërmjet lojës fëmijët mund të jenë dikush, në çdo vend dhe në çdo kohë. Pjesa më e madhe e lojërave që luajnë fëmijët parashkollorë janë simbolike. Fëmijët pretendojnë të bëjnë gjoja sikur, janë dikush me një veprim ose objekt, nënkuptojnë një veprim ose një objekt tjetër. Lojërat dhe veprimtaritë fizike, si vrapimi, ngjitja, rrëshqitja, lëkundja, lojërat me top, loja luftash, mundjet, gjuajtjet, etj., janë karakteristike për fëmijët e vegjël, në veçanti kur ato luhen në vende të hapura dhe oborre.

Loja është e rëndësishme, sepse:

♦ i ndihmon fëmijët të rriten të shëndetshëm. Kur fëmijët vrapojnë, kapërcejnë, rrotullohen, gjuajnë ose notojnë ata janë duke forcuar muskujt. Ata shpenzojnë energji dhe kjo i bën të ndihen të lodhur dhe të uritur. Fizikisht, loja zhvillon forcën, durimin dhe aftësinë për të ruajtur ekuilibrin. Trupi forcohet më shumë kur fëmijët luajnë lojëra që i zhvillojnë fizikisht dhe kjo i bën ata të ushqehen dhe të flenë më mirë.

- ♦ i njeh fëmijët me botën që i rrethon. Lodrat i ndihmojnë fëmijët të mësojnë kuptimin e fjalëve në përgjithësi, nëpërmjet përdorimit të komandave të ndryshme, si: "Ndalo!", "Shko!", "Hajde!", "Këndo!", "Kërce!" etj.
- ♦ i ndihmon fëmijët të mësojnë rreth njerëzve. Ndërsa luajnë, fëmijët mësojnë të zbatojnë rregullat e lojës, radhën dhe shprehi të tjera të lojës me të tjerët. Kur ata aktrojnë, luajnë mes ndjenjave të tyre dhe të personazhit, imitojnë veprime dhe gjeeste të shokëve të tyre. Gjatë lojës, fëmijët mund të udhëheqin, ose të udhëhiqen nga të tjerët, të kuptojnë më mirë vetveten dhe të tjerët. Nëpërmjet lojës fëmijët ndihmohen të dallojnë çfarë u pëlqen dhe çfarë jo, cilin rol të të rriturve duan të luajnë gjithmonë dhe cilave u shmangen.
- ♦ i ndihmon fëmijët të ndihen mirë. Fëmijët i kënaq loja, pavarësisht nga rezultati i saj. Kur loja është e vështirë dhe fëmijët ia dalin mbanë, ata ndihen të gjallëruar dhe mund të shfaqin shenja kënaqësie.
- ♦ përcjell te fëmijët vlera humane. Fëmijët mësojnë të tregohen të kujdesshëm, të durueshëm në zhvillimin e lojës. Ata mësojnë të zgjidhin lojëra gjuhësore, fjalë kyçe, gjëegjëza dhe situata të thjeshta problemore. Në lojë, fëmijët mësojnë çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar; mësohen të jenë sportivë, të ndershëm dhe "të mos mashtrojnë"; zhvillojnë më tej fantazinë; mësojnë të dëgjojnë të tjerët, të ndjekin udhëzime dhe të respektojnë rregullat e lojës. Këto aftësi do të jenë të rëndësishme për fëmijët kur të rriten.

Lodrat e preferuara të fëmijëve

Lodrat mund të grupohen sipas llojeve të lojërave ose sipas funksioneve të tyre didaktike.

Për lojërat në tavolinë

Në këtë grup futen të gjitha lodrat që përdoren për lojërat në tavolinë të tilla, si:

- ♦ pazllat (copëzat) për lojërat formuese,
- ♦ zarat dhe fusha e vizatuar për lojën "Mos u nxeh",
- ♦ gurët dhe letrat e stampuara për lojërat e dominove, të cilat vendosen sipas rregullit të përcaktuar,
- ♦ fusha dhe gurët e shahut për lojën e shahut dhe të damës,
- ♦ letrat e veçanta për lojën me letra, në të cilat numri përkon me sasinë, frutat lidhen me ngjyrën, shkronjat renditen sipas alfabetit etj.

Për lojërat me top dhe me litar

Lojërat gjatë të cilave fëmijët përdorin materiale dhe mjete të ndryshme, si: topi, litari dhe birilat janë nga më të larmishmet dhe më të dashurat për fëmijët e kësaj moshe. Ato jo vetëm i zhvillojnë ata nga ana fizike, por dhe u falin shumë kënaqësi. Përmendim këtu:

- ♦ Topat e ndryshëm: të futbollit, të pingpongut, tenisit, prej lecke, sfungjeri etj.;
- ♦ Litarët e gjatësive të ndryshme;
- ♦ Birilat dhe shishet plastike etj.

Lodrat dhe mjetet për lojërat me profesione

Në këtë grup futen të gjitha lodrat dhe mjetet që u përkasin profesioneve të ndryshme. Fëmijët e kësaj moshe kanë dëshirë të imitojnë profesione dhe të bëjnë “kinse” si të rritur.

- ◆ Nëse fëmijët duan të luajnë “doktorësh” dhe do të imitojnë veprimet e mjekut, atëherë atyre u duhen sa më shumë mjete dhe pajisje që përdorin mjekët, si: stetoskopi, aparati i tensionit, termometri, bluza e bardhë, receta, stilolapsi etj.
- ◆ Nëse fëmijët duan të luajnë “shtëpish” dhe të imitojnë shumë profesione që kanë lidhje me të, atëherë të rriturit duhet t’u sigurojnë fëmijëve kukulla-njerëz që u përkasin racave, kulturave dhe gjinive të ndryshme ose roleve të ndryshme të anëtarëve të familjes ose të personazheve të filmave dhe revistave të ndryshme; enë kuzhine të sigurt për fëmijët: tenxhere, pjata, tiganë, tasa, tava etj.; artikuj ushqimorë; brumë; lodra që imitojnë sobën, lavapjatën dhe pajisje të tjera shtëpiake; sendet që duhen për shtrimin e tavolinës së bukës, për pastrimin e shtëpisë, orendi shtëpiake, si dhe materiale dhe mjete që përdorin kuzhinieri, pastruesja, hidrauliku, bojaxhiu, elektrikisti, tekniku i telefonit, zjarrfikësi, marangozi etj.
- ◆ Nëse fëmijët duan të luajnë role kafshësh duke u bërë personazhe të përrallave dhe tregimeve, atëherë të rriturit duhet t’u sigurojnë lodra pellushi, maska, veshje që imitojnë lëkurën e kafshëve, dekorime të mjedisit ku jetojnë kafshët, si: kolibe, kotec, ahur etj., kolazhe pikturash që mund të përdoren si sfonde etj. Kur luajnë lojëra të tilla, fëmijët mund të sjellin në klasë edhe kafshë, shpendë të gjalla shtëpiake: mace, lepur, pulë, zogj etj. Kafshët dhe karakteret imagjinare, si: shtrigat, magjistarët, fantazmat, gjithashtu, pasurojnë bashkëveprimin dhe zhvillojnë fantazinë e fëmijëve.

Lodrat dhe materialet që kanë lidhje me lëvizjen dhe zhvendosjen

Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjitha ato lodra, materiale dhe mjete që kanë lidhje me transportin, hapësirën, shkencën, zbulimin, ndërtimin etj. I quajmë lodra lëvizëse, sepse ato kanë lidhje me lëvizjen dhe zhvendosjen në hapësirë. Ndër këto lodra përmendim:

- ◆ Të gjitha mjetet e transportit tokësor, detar, ajror;
- ◆ Lodrat që imitojnë fluturimin në hapësirë, si: raketa, anija kozmike, veshjet e astronautëve, teleskopi etj.;
- ◆ Bllloqet, kubat me ngjyra, forma e madhësi të ndryshme, tullat e vërteta, degët e pemëve, guriçkat me të cilat fëmijët projektojnë, ndërtojnë makete shtëpish, kalash, qytetesh, rrugë, semaforë etj. etj.
- ◆ Argjilën, baltën dhe plastelinën.

Lodrat dhe materialet statike

Në këtë grup hyjnë të gjitha ato objekte, lodra dhe pajisje të mëdha, shpesh të ngulura apo të varura në mjedise të brendshme ose të jashtme, zhvendosja e shpeshtë e të cilave është e pamundshme. Këtu përmendim:

- ◆ Lisharëset, varkat dhe lëkundëset;
- ◆ Shtëpitë e mëdha;
- ◆ Lodrat në parkun e lojërave;

- ◆ Rrotullamet e ndryshme;
Rrëshqitëset etj.

Materialet dhe mjetet didaktike

Krahas lodrave, fëmijët parashkollorë shfaqin interes për librat, mjetet e vizatimit, letrat me ngjyra dhe për mjetet që gjejnë në mjedisin ku jetojnë. Nëpërmjet këtyre materialeve fëmijët nxënë, kënaqen, argëtohen dhe mësojnë si të kujdesen për mjedisin që i rrethon. Më në detaje mund të përmendim:

- ◆ Librat për fëmijë, revistat dhe albumet me figura dhe ngjyra të ndryshme;
- ◆ Materialet e vizatimit, si: fletore, lapsa, vizore, gomë, bojëra uji, dhjami, shkumësa etj. Është shumë e rëndësishme që fëmijët të njihen me elementet e pikturës që në këtë moshë. Përdorimi i bojërave pluhur u fal fëmijëve shumë kënaqësi kur ata pikturojnë gishtërinjtë e tyre për të formuar figura të ndryshme. Në këto raste, procesi është më i çmuar sesa produkti që nxjerr fëmija.
- ◆ Letrat dhe materialet që përdoren për të bërë kolazhe me tematikë të lirë ose të përcaktuar;
- ◆ Mjetet e punimeve me dorë, si: letrat me ngjyra, gërsërët, ngjitëset, mjete kancelarike, materiale tekstile, kopsa, penj, gjilpërë etj.
- ◆ Tabela e bardhë dhe e zezë. Sipërfaqet e tabelave u ofrojnë fëmijëve mundësi për të praktikuar dorën, të shkruarit, të vizatuarit dhe zhvillimin e fantazisë. Të paturit e një table të tillë, u krijon mundësi fëmijëve të zhyten në botën e krijimtarisë.

Si mund të ndihmohet fëmija të luajë në shtëpi

Kur fëmija luan, prindi e vëzhgon, tregohet bashkëpunues, lehtësues, dhe ndihet pjesë e gëzimit dhe e mërzitjes që përjeton fëmija. Biseda me të e ndihmon prindin të kuptojë më mirë fëmijën e tij. Lojërat e fëmijës duhet të jenë krijuese, të lira dhe në përshtatje me dëshirat dhe interesat personale.

Prindi duhet të marrë informacion të vazhdueshëm. Për të qenë pjesë e lojës së fëmijës, prindi duhet të ketë njohuri për karakteristikat të zhvillimit të fëmijës në moshën që ka. Kjo do ta ndihmojë të sigurojë lodrat, materialet dhe mjetet e duhura për moshën e fëmijës.

Prindi duhet të jetë një shembull i mirë për fëmijën. Fëmijat imiton shumë veprime, gjeste dhe sjellje të të rriturit kur luan. Prandaj prindi duhet të kënaqet dhe të gëzohet me fëmijën gjatë lojës që luajnë së bashku.

Prindi duhet të sigurojë lodra që nuk e dëmtojnë fëmijën, një hapësirë të mjaftueshme dhe kohë të përshtatshme për të luajtur me fëmijën.

Prindi duhet të ndjekë lojën e fëmijës. Fëmija duhet pyetur, nxitur dhe t'i merret mendimi për të zgjedhur lojën që do të luajë. Prindi mund të luajë me fëmijën, por duhet ta lërë të bëjë lojën

e tij. Ai është pjesë e lojës, por jo drejtuesi i saj. Loja duhet të zgjasë aq sa i intereson fëmijës.

Prindi duhet të jetë krijues, të sigurojë materiale të ndryshme krijuese, të shfrytëzojë mjete rrethore në funksion të lojës.

Pra, fëmijët përfitojnë shumë nga lojërat, aktivitetet dhe veprimtaritë që zhvillohen si në shtëpi edhe në kopsht, si në rastin kur luajnë vetëm, edhe në rastin kur luajnë me 1 apo më shumë fëmijë. Në përgjithësi, fëmijët kanë besim për atë çka janë dhe për atë që janë në gjendje të kryejnë. Prindi dhe mësuesi e ndihmojnë fëmijën të përmbushë të drejtën për edukim dhe formim cilësor, e ndihmojnë fëmijët të mësojë atë për të cilën ka nevojë, garantojnë sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijës.

Kapitulli 10

Probleme tipike të fëmijëve parashkollorë në sjellje dhe veprime

Pse fëmijët shfaqin veprime të dhunshme

"Fëmijët nuk lindin agresivë, por e mësojnë atë gjatë rritjes" është një pohim i cili na bën të mendojmë për përgjegjësinë që kemi si të rritur në lidhje me mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët i mësojnë sjelljet dhe veprimet e dhunshme nga familjarët, nga fëmijët e tjerë ose nga emisionet televizive që shohin. Shpesh, fëmijët agresivë nuk kanë marrëdhënie pozitive me shokët dhe paraqesin vështirësi në menaxhimin e sjelljeve të dhunshme.

Studimet kanë treguar se agresivitetit të fëmijët e moshës 2-5 vjeç vjen duke u ulur, sepse fëmijët fillojnë të bërdorin gjuhën si mjet komunikimi. Megjithatë çdo fëmijë e sheh botën të rrotulluar rreth vetes dhe kjo e bën që ai të mos e ketë zhvilluar sensin e empatisë (pra të ndjejë atë që ndjen tjetri). Duke qenë në moshën që i duan të gjitha gjërat për vete, fëmijët mund të mos dallojnë dëshirat e shokëve për t'iu bashkuar një loje me të cilën ai luan i vetëm. Për të kontrolluar agresivitetin të fëmijët, i rrituri duhet:

- ♦ të shpjegojë gjërat që ndodhin, nëpërmjet hisotrive, lojës në role apo lojës me kukulla
- ♦ të jetë i durueshëm, këmbëngulës dhe i qartë në gjërat që kërkon nga fëmijët
- ♦ ta organizojë mjedisin në mënyrë të tillë që fëmijët t'i kufizojnë situatat konfliktuale
- ♦ t'ua bëjë të qartë fëmijëve se çfarë kërkohet prej tyre sa i takon sjelljes, si dhe t'u mësojë pasojat që vijnë nga sjelljet e gabuara
- ♦ të kufizojë lodrat që stimulojnë agresivitetin
- ♦ të shmangë çdo formë dhune
- ♦ ti ftojë fëmijët të gjejnë zgjidhje apo t'u tregojë një histori që ata ta kuptojnë më mirë problemin, në rast se ndodh një situatë konfliktuale
- ♦ t'u afrohet fëmijëve kur e sheh që po "ndizen gjakrat", pasi prania e tij do ta bëjë fëmijën të qetësohet dhe të mos veprojë.
- ♦ të veprojë nëse fëmija po shtyn a po gjuan ndonjë shok, duke e larguar që andej dhe duke i qëndruar pranë sa të gjejë diçka tjetër për t'u marrë
- ♦ ta largojë fëmijën nga mjedisi ku ndodhet nëse ky po e prish lodrën me të cilën po luante
- ♦ t'u japë mundësi fëmijëve të flasin për situata problematike, si dhe të ofrojnë zgjidhjen e tyre

- ♦ t'u thotë fëmijëve çdo ditë gjëra pozitive
- ♦ t'i dëgjojë ato që thonë fëmijët, t'i lërë të shprehën dhe t'i ndihmojë për të qenë më të qartë në ato që thonë duke i miratuar mendimet që shprehin

Pra duke jetuar në shoqëri fëmija mëson si të sillet. Agresiviteti është një ndër sjelljet e mësuara. Fëmijët duhet ta njohin dhe të vlerësojnë veten e tyre për atë që janë dhe për atë që dinë të bëjnë. Pjesë e vetëvlerësimit është edhe zotërimi i ndjenjës që secili ka një vend të tijin, se ka njerëz që e duan dhe e mbrojnë. Për këtë u fol në mënyrë të hollësishme në kapitujt e



mëparshëm.

Pse gënjejnë fëmijët

Gënjeshttrat e fëmijëve parashkollorë janë mëse të zakonshme dhe pranohen si pjesë e zhvillimit të tyre. Në moshën 4-6 vjeçare fëmijët gënjejnë më shumë. Studimet kanë treguar se në moshën 4 vjeçare një fëmijë mund të gënjejë një herë në 2 orë, kurse në moshën 6 vjeçare mund të gënjejë çdo 90 minuta. Duke u rritur, gënjeshttrat shtohen, bëhen më të sofistikuara e me një fjalor më të përzgjedhur. Fëmijët parashkollorë nuk arrijnë ta kuptojnë që, të gënjesht, është një veprim i gabuar dhe i pandershëm. Ata gënjejnë për arsye nga më të ndryshmet, si p.sh:

- ♦ për të mbuluar një gabim me shpresën se nuk do të ndëshkohen.
- ♦ për të zbuluar se si do të sillet i rrituri apo shokët në rastin kur ai gënjen.
- ♦ për t'u bërë përshtypje të tjerëve, duke ekzagjeruar një ngjarje.
- ♦ për të tërhequr vëmendjen edhe kur e dinë se tjetri e di të vërtetën.

Nëse i rrituri do që fëmija t'i tregojë të vërtetën, atëherë duhet të gjejë mënyrën e duhur për të biseduar me të.

Duhet të dimë se kjo është mosha kur imagjinata dhe fantazia e fëmijës janë mjaft të zhvilluara. Marrja e informacioneve nga burime të ndryshme, e bën fëmijën të mendojë dhe të thotë gjëra të pandodhura më parë apo të sajuara pa paramendim apo keqdashje.

I rrituri duhet ta mësojë fëmijën, edhe të dallojë gënjeshttrat e vërteta nga "gënjeshttrat e bardha", të cilat nuk shkaktojnë dëm.

2 tipet më të zakonshme të gënjeshttrave të fëmijëve janë:

- ♦ **Përrallat e gjata.** Fëmijët mund të tregojnë një histori që nuk është e vërtetë, ose që është shumë e ekzagjeruar nga ajo që ka ndodhur realisht. Fëmijët e kësaj moshe kanë imagjinatë të zhvilluar dhe janë duke mësuar nëse ajo që shohin, dëgjojnë është e vërtetë apo jo. Kur fëmijët tregojnë histori të gjata shpesh janë duke treguar gjëra që do të donin t'u ndodhnin. I rrituri duhet t'i dëgjojë fëmijët dhe të kapë të vërtetën që fshihet në këtë histori.

♦ **Gënjeshttrat** që kanë lidhje me diçka që fëmijët duan ta shmangin ose që nuk e duan. Shpesh fëmijët i thonë gënjeshttrat për të dalë nga situata apo për të arritur atje ku duan. Në këtë rast i rrituri duhet të ndërhyjë që ta mësojë fëmijën të mos gënjejë. Mund të tregohet historia e fshatarit që gënjente që thërriste kot “ujku, ujku” dhe në fund e pësoi.

Edhe pse fëmijët nuk i dallojnë ende pasojat që mund të sjellë gënjeshttra, mirë është që i rrituri t'u mësojë të thonë të vërtetën. Fëmijët mbi moshën 5 vjeç e kuptojnë se ç'do të thotë të gënjeshtrosh. Arsye të vazhdojnë të gënjejnë janë të ndryshme:

- ♦ t'u shpëtojnë ndëshkimeve
- ♦ t'u bëjnë përshtypje të tjerëve
- ♦ të marrin diçka që duan
- ♦ të mbrojnë një pjesëtar familjeje
- ♦ kur dëgjojnë edhe prindërit që gënjejnë

Pavarësisht arsyes, prindërit duhet t'u japin fëmijëve të kuptojnë se ata nuk po tregojnë të vërtetën.

Këtë mund ta zbulojnë:

- ♦ duke parë fytyrën e fëmijëve: një fëmijë që gënjen nuk është i qetë
- ♦ nga qartësia e fjalëve: nëse gënjen, fëmija mund të mos ketë qartësi në të shprehur
- ♦ spontaniteti: zakonisht fëmijët i mendojnë gënjeshttrat dhe fjalët që duhet të thonë për të mbuluar të vërtetën.

Çfarë mund të bëjë i rrituri

- ♦ Të bisedohet me fëmijët për rëndësinë që ka thënia e të vërtetës;
- ♦ Të mos i gënjejë fëmijët.
- ♦ Të mos e bëjë fëmijën të turpërohet për një gënjeshtër të thënë, por të nxitet për të thënë të vërtetën.
- ♦ Pas një gënjeshtreje të thënë, i rrituri duhet të kërkojë nga fëmija të gjejë zgjidhje për të shkuar drejt së vërtetës.
- ♦ Të vendosë rregulla, ndër të cilat duhet të ketë edhe rregulla që lidhen me gënjeshtren.

Pse kafshojnë fëmijët

Kafshimi është një dukuri e zakonshme te fëmijët. Kafshimi shkakton dhimbje dhe frikë si për fëmijën që kafshon ashtu edhe për fëmijën e kafshuar. Në përgjithësi, kafshimi është një dukuri që ndodh te fëmijët nën 3 vjeç. Nëse ky veprim ndodh te fëmijët e moshës parashkollorë do të thotë që fëmija është i stresuar dhe kafshimin e përdor për t'u çliruar prej tij. Por mundet, gjithashtu, që fëmija të jetë i mërzitur me një shok dhe e gjen si mënyrë për të reaguar ndaj tij, pa menduar dhimbjet që mund t'i shkaktojë.

Si në rastin kur fëmija mund të kafshojë veten, edhe në rastin kur kafshon shokun, ai duhet ndihmuar ta shprehë zemërimin në mënyra të tjera, një ndër të cilat edhe përmes fjalëve.

I rrituri duhet të veprojë shpejt, me vendosmëri dhe me qetësi. Ai duhet t'i marrë fëmijës premtimin se nuk do ta bëjë më një veprim të tillë. Por ky është një proces që, siç e kemi theksuar

edhe në raste të tjera, kërkonë kohë. Reagimet e menjëhershme apo vendimet ekstreme nuk e zgjidhin situatën.

Kërcënimi, fyerja, sharja

Fëmijët e moshës parashkollorë janë në proces njohjeje dhe vlerësimi të vetes. Një dukuri që mund të ndodhë mes fëmijëve parashkollorë është edhe fyerja, vënia e nofkave, dhunimi të cilat e bëjnë fëmijën të ndihet keq. Për këtë arsye, në rastin më të parë, duhet vepruar.

Këto procese nuk zgjidhen në rast se nuk ndërhyjnë i rrituri. Shpesh sharjet apo fyerjet që ndodhin në këtë moshë, kanë rrezikun e vazhdimet edhe në vitet e mëvonshme. Kjo do të thotë që pasojat mund të jenë të rënda dhe frenuese për zhvillimin normal të fëmijës. Për këtë arsye, sjellje të tilla duhen vëzhguar dhe zgjidhur sa më herët që të jetë e mundur. Disa studime tregojnë që fëmijët fillojnë të marrin role pro sociale ose anti sociale duke filluar që në moshën parashkollore. Gjithashtu studimet tregojnë se keto role lidhen dhe me njohjen ose jo të emocioneve bazë.

Llojet e shfaqjes së një dhunimi të tillë janë pjesë të abuzimit fizik, emocional dhe verbal. Kjo dukuri ndodh zakonisht kur një fëmijë apo një grup fëmijësh duan të zotërojnë fëmijë apo grupe të tjera, t'i nënshtrojnë dhe të kenë forcë vepruese mbi ta.

FIZIKE	PSIKOLOGJIKE	
goditje	fyerje	përgojim
shkelmim	kërcënime	thumbim
gjuajte me grusht	thirrje me emër-nofkë	injorim
shtyrje	komente për pamjen fizike ose të folurin	mospranim në aktivitete grupi.
vjedhje	komente mbi prejardhjen	
ngacmime		
REZULTATI		
Mund ta dëmtojë fëmijën në trup, në veshje në lodra duke e bërë të ndihet keq me veten.	E bën fëmijën të ndihet keq me veten.	E bën fëmijën të ndihet i veçuar dhe jo pjesë e grupit.

Sharjet, ofendimet dhe dhuna fizike mund të sjellë pasoja të pakëndshme për jetën e mëtejshme të fëmijëve. Ata mund të frikësohen, të shprehin shenja nervozizmi, të ndihen të shqetësuar, të përjetojnë ankth. Kur të rriten, ata mund të kenë edhe probleme të shëndetit mendor.

Për këtë arsye me t'u dëgjuar ndonjë fyerje apo sharje mes fëmijëve, i rrituri duhet të bisedojë me fëmijën për të marrë vesh nëse kjo është hera e parë apo ka pasur edhe raste të tjera. Fëmija duhet qetësuar dhe duhet vlerësuar për anët e mira që ka, për pavërtetësinë e fjalëve të thëna dhe të diskutojnë së bashku për të gjetur zgjidhje.

Fëmijët duhen mësuar si të ndërtojnë mekanizma mbrojtës për të përballuar situata të ndryshme. Ata duhet të kenë besim dhe shprehitë e duhura për t'u përballuar me një problem apo për t'u përballuar me dikë. Në grup mund të kemi fëmijë që para një problemi sado të vogël tërhiqen dhe fillojnë të qajnë ose na kërkojnë ndihmë ne për të ndërhyrë.

Fëmijët duhen mësuar edhe të jenë elastik, të veprojnë vetë pa ndihmën e të rriturit, pra të përballojnë me sukses një problem apo një situatë të vështirë. Me një fjalë të jenë të zotët e vetes.

Fëmijët mund të jenë elastikë në situata të ndryshme, si p.sh.

- ♦ kur janë të bindur se mund të përballen vetë me fëmijën që i mërzi apo që i ngacmo; gjejnë dikë për t'i ndihmuar kur kanë nevojë; gjejnë mënyra për ta zgjidhur një problem; kontrollojnë veten dhe nuk bien pre e provokimit
- ♦ kur janë të bindur se jetojnë mes njerëzve që i duan; kanë kënaqësi të bëjnë gjëra për u pëlqejnë të tjerëve, të tregojnë se mendojnë për ta e i respektojnë
- ♦ kur kanë njerëz që e i duan, i ndihmojnë dhe i mbështesin; kanë pranë njerëz që i mësojnë t'i bëjnë gjërat sa më mirë; t'i bëjnë vetë; njerëz që i ndihmojnë në situata të vështira kur ata kërkojnë ndihmë.

Fëmijët e vegjël kanë vështirësi në përballimin e situatave që i vënë në siklet, i mërzi dhe që nuk i përballojnë dot. Në veprimtaritë dhe detyrat e ndryshme fëmijët mësohen:

- ♦ të kuptojnë ndjenjat dhe aftësitë që kanë.
- ♦ të dallojnë se çfarë i mërzi dhe i bën të ndihen keq.
- ♦ të shprehin ndjenjat nëpërmjet vizatimit, ngjyrosjes, lojës me pupeta, me kukulla dhe lojëra të tjera të këtij tipi.
- ♦ të shfrytëzojnë histori, që trajtojnë raste të ngjashme me personazhin.
- ♦ të zhvillojnë më tepër lojëra bashkëpunuese se konkurruese.
- ♦ të kuptojnë se sharja, fyerja ose talljet e dëmtojnë tjetrin.

Mësuesi më i mirë i përmirësimit të sjelljes është praktika. Në veprimtarinë dhe në marrëdhëniet e përditshme me shokët, fëmijët mësojnë dhe dallojnë se çfarë duhet të bëjnë e çfarë jo. Fëmijët duhen mësuar me pasojat që sjell një veprim apo sjellje e gabuar. Nëse një fëmijë dëmton një lodër, atëherë lodra do t'i merret dhe ai nuk do të luajë më me të. Në rast se një fëmijë nuk sillet si duhet, atëherë ai do ta humbë privilegjin të bëjë një lojë apo diçka argëtuese.

Për të pasur marrëdhënie të mira me shokët fëmijët duhet të mësojnë:

- ♦ Shprehitë e komunikimit – përdorimin e fjalëve të duhura, buzëqeshjen dhe shprehjet e fytyrës, përdorimin e syve gjatë komunikimit dhe dëgjimin aktiv.
- ♦ Shprehitë e futjes në një grup fëmijësh – si të prezantohet, si ta justifikojë dëshirën për të qenë pjesë e atij grupi etj.
- ♦ Shprehitë për të shkuar mirë në grup – ndarja e gjërave, marrja e lejes, respektimi i radhës, ndjekja e rregullave, bashkëpunimi, toleranca dhe vlera të tjera që duhen në një bashkëjetesë paqësore, menaxhimi i konfliktit dhe dhënia e ndihmës.

Që fëmijët të përmirësojnë sjelljen dhe të "tremben" nga pasojat për gabimet që bëjnë, duhet që:

- ♦ I rrituri t'u përmendë vazhdimisht pasojat e veprimeve të gabuara siç janë: frenime, ndërprerje të një veprimtarie, heqja e lodrës së dashur, humbje privilegji etj. Duhet të merren menjëherë masa, në mënyrë që fëmija ta kuptojë gabimin.
- ♦ Dënimi të mos zgjasë shumë, në mënyrë që fëmija të marrë një shans të dytë për ta përmirësuar sjelljen.
- ♦ Para se i rrituri të japë dënimin, fëmija ta dijë paraprakisht se çfarë pëson, pasi bën një veprim të gabuar. Qëllimi i të rriturit është që fëmija të mendojë para se të veprojë.
- ♦ Në pjesën më të madhe të rasteve, i rrituri t'i japë fëmijës një paralajmërim para se ta dënojë.
- ♦ Pasojat duhet të vijnë menjëherë pas një veprimi apo sjelljeje të gabuar, po i rrituri nuk duhet t'i japë ato me pamje të egërsuar apo me ton ndëshkues. Fëmija i merr pasojat si rezultat i veprimit të gabuar që ka kryer ai vetë.

I rrituri duhet të mbajë gjithnjë në mendje se në çdo rast dënohet sjellja e fëmijës dhe jo fëmija. Pasojat apo dënimet e fëmijës nuk janë kryesoret në përmirësimin e sjelljes së gabuar.

Ne duam që sjelljet dhe veprimet negative të pakësohen e të shfaqen sa më rrallë të jetë e mundur. Prandaj ne duhet të përqendrohemi te përfitimi i sjelljeve të mira, të shëndetshme dhe të sigurta për fëmijën.

Për këtë i rrituri duhet:

- ♦ të shprehë kënaqësi për një veprim apo sjellje të fëmijës.
- ♦ ta përshkruajë pse i pëlqeu.
- ♦ të përpiket të çmojë punën e një fëmije, por jo duke e krahasuar me atë të fëmijëve të tjerë.
- ♦ të evidentojë sjelljet e mira më tepër se sa ato të këqijat.
- ♦ të ruajë një raport pak a shumë të tillë: 6 herë ta vlerësojë pozitivisht dhe 1 herë ta kritikojë fëmijën.
- ♦ të kërkojë dhe të këmbëngulë për ndryshime dhe hapa të vegjël suksesi.
- ♦ të pranojë që fëmijët janë individë të veçantë dhe t'i trajtojë si të tillë.

Si menaxhohen emocionet negative të fëmijëve të vegjël

Çdo njeri ka emocione. Të gjitha emocionet janë universale edhe pse shfaqen në mënyra të ndryshme në kontekste të ndryshme. Është shumë e rëndësishme për ne të rriturit t'i mësojmë fëmijët të njohin dhe t'i kuptojnë shpërthimet emocionale. Një



menaxhim i shëndetshëm i emocioneve do të thotë të njohësh format dhe mënyrat e ndryshme që i nxisin emocionet të shfaqen; të kuptosh çfarë fshihet pas emocioneve të pashprehura; si dhe të ndihmosh veten për t'i nxjerrë ato. Ndër emocionet që shfaqen në mënyrë tipike në moshën e fëmijëve parashkollorë janë: frika, zemërimi, mërzitja, gëzimi dhe habia.

♦ **Frika** ka lidhje me nevojën për të qenë i sigurt. Një fëmijë i frikësuar ka nevojë të largohet nga një vend apo nga dikush që i ngjall frikë, si për shembull nga një qen. Për këtë arsye, mësuesja duhet t'i thotë fëmijës "E shoh që ke frikë. Çfarë mund të bëj unë që t'i të mos kesh frikë nga qeni?" në vend që t'i thotë "Po pse, nga qeni ke frikë ti? Shih sa i mirë është ai!". Fëmija duhet ndihmuar të gjejë shkakun e frikës në mënyrë që më pas të gjejë zgjidhjen.

♦ **Zemërimi** është i lidhur me nevojën për të qenë i respektuar. Zemërimi shpesh shprehet me një veprim energjik me qëllimin për t'i ndryshuar gjërat. Zemërimi mund të shfaqet si pasojë e një ngjarjeje të ndodhur më parë, ose si shkak i një ngjarjeje të çastit. Është një reagim i shpejtë për të bërë një ndryshim sa më të shpejtë. Zemërimi është një emocion që shfaqet shpesh te fëmijët gjatë kohës që ata punojnë me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, sa herë që te fëmijët shfaqen shenja zemërimi, situata duhet kontrolluar, në mënyrë që të mos degjenerojë në sjellje apo veprime të njëpasnjëshme të papëlqyera. Një fëmijë i zemëruar mund ta shprehë atë duke dalëq jashtë dhe duke bërtitur me zë të lartë, ose duke përplasur topin disa herë në oborr, ose duke vizatuar fort mbi një letër, duke numëruar ose duke folur me një person të cilit i beson.

♦ **Mërzitja** është e lidhur me nevojën për t'u ndierë mirë. Mërzitja shkaktohet kur humbasim diçka të dashur, kur prishet një rehati, kur na ndërpritet një veprimtari që e bëjmë me qejf. Mërzitja është një emocion që shfaqet pas një veprimi në të shkuarën, të cilin nuk e rikthejmë dot. Për t'u rikthyer në gjendje normale, duhet të krijojmë kushte dhe mundësi të reja, të pranueshme nga fëmijët.

♦ **Gëzimi** është i lidhur me nevojën për t'u pranuar nga të tjerët. Gëzimi është një emocion pozitiv, i cili lidhet me një sukses, me një arritje, me një vlerësim pozitiv, të cilin përpiqemi ta ndajmë me të tjerët. Krenaria dhe kënaqësia janë pjesë e shfaqjes së gëzimit. Pranimi i suksesit dhe dëshira për ta ndarë me të tjerët na nxit për të ecur përpara. Por një shfaqje e tillë mund të jetë e papranueshme në raste apo kontekste të caktuara. (Në rastin e lojës, gëzimi i skuadrës fituese mund t'i acarojë fëmijët e skuadrës humbëse, prandaj emocionet pas lojës duhen menaxhuar me kujdes).

Pse fëmijët shprehin kriza nervozizmi

- ♦ Mund të mos kuptojnë diçka me të cilën po merren apo po bëjnë.
- ♦ Mërziten kur të tjerët nuk e kuptojnë atë që thonë.
- ♦ Nuk ka mësuar ende si t'i zgjidhin problemet dhe thyhen para çdo vështirësie që u del.
- ♦ Mund të jenë të sëmurë, por nuk e kuptojnë.
- ♦ Mund të jenë të uritur, por nuk e kuptojnë.
- ♦ Mund të jenë të lodhur, të kenë fjetur vonë etj.
- ♦ Mund të jenë duke reaguar ndaj ndonjë stresi apo ndryshimeve që kanë ndodhur në jetën apo familjen e tyre.
- ♦ Mund të jenë xheloz ndaj një shoku, kushëriri apo pjesëtarit të familjes dhe të gjejnë formatë dhunshme për t'u shprehur.

T'i ndihmosh fëmijët t'i njohin, t'i emërtojnë dhe t'i përballojnë me sukses këto emocione është një punë e gjatë. Fëmijët duhet të kuptojnë që çdo emocion është i dobishëm, që emocionet duhet të çlirohen, por mënyra e shprehjes së tyre duhet kontrolluar dhe duhet bërë në mënyrën e duhur.

Fëmijët duhet t'i shprehin emocionet nëpërmjet vizatimit, ngjyrosjes, punimeve me plastelinë, lëvizjeve fizike etj. Fëmijët duhen mësuar që për emocionet që ndiejnë, të flasin me dikë që i besojnë. Në lojë të gjithë fëmijët duan të fitojnë, por vetëm njëra është skuadra që ia arrin. Mërzitja është e natyrshme te skuadra tjetër, por gjetja e shkaqeve të humbjes ia vlen të diskutohet në qetësi. Procesi i menaxhimit të një emocioni kalon në tri faza: pranimi, analiza dhe të shprehurit e emocionit. Duhet të mbajmë parasysh se çdo emocion i shprehur në mënyrë të papërshtatshme ka lidhje me një nevojë të papërmbyshur. Në fillim emocioni duhet pranuar. Më pas duhet analizuar mënyra e shprehjes së tij dhe përcaktimi i shkaktuesit apo faktorit ndikues që solli një reagim të tillë. Së fundi emocioni duhet shprehur nëpërmjet fjalëve, veprimeve apo një mënyre që pranohet nga të tjerët.

Si t'u mësohet fëmijëve vetëkontrolli

- ◆ Përcaktoni saktë se çfarë kuptoni me "sjellje të mirë" – Fëmija duhet ta kuptojë atë që kërkohet prej tij. Fëmija duhet të njohë rregullat dhe kufijtë, të cilat duhet të jenë të pakta në numër.
- ◆ Bëni sugjerime pozitive – Përdorni sa më pak fjalitë që fillojnë me "Mos..." dhe "Jo... ". Në vend të thoni "Mos e përplas kukullën në tokë", thuajini "Pa dale, të shohim se çfarë ka kukulla. Sikur dëgjova një zë?"
- ◆ Jepni mundësi për zgjedhje – Fëmija është i prirur të kundërshtojë. Për këtë jepini mundësi të zgjedhë mes dy-tre alternativave.
- ◆ Ridrejtoni sjelljen – Jepini mundësi fëmijës të vazhdojë të bëjë diçka të ngjashme me atë që po bën, por që ia diktoni ju tashmë.
- ◆ Respektoni fëmijën – Analizoni sjelljen dhe veprimin e fëmijës, jo atë vetë.
- ◆ Ndryshoni situatën – Merrni ju masa që fëmija të minimizojë veprimet e dhunshme.
- ◆ Nxisni te fëmijët mendimin e mirë për veten – Në çdo veprim bëjini fëmijët të ndihen mirë. Lavdërojini kur bëjnë gjëra të mira.
- ◆ Bëhuni shembull apo model për fëmijën.

Strategji që funksionojnë

Afrojuni fëmijës me qetësi

- ◆ Uluni në të njëjtin nivel me fëmijën.
- ◆ Flitini me zë të ulët dhe prekeni lehtë.

Respektoni ndjenjat e fëmijës

- ◆ Përmbliidhni dhe pohoni atë që ndien fëmija.
- ◆ Shmangni pyetjet derisa fëmija të qetësohet.

Mblidhni informacion

- ◆ Vëzhgojini fëmijët.
- ◆ Shikojini si sillen.
- ◆ Drejtojuni pyetje që fillojnë me "Pse?"

Ripohoni atë që thonë fëmijët

- ◆ Bëni një përmbledhje të problemit që e shqetëson fëmijën.

Kërkoni zgjidhje të problemit

- ◆ Fëmijët duhet të japin zgjidhje dhe t'i justifikojnë ato.

Mbështetini zgjidhjet e fëmijës

- ◆ Ndiqeni fëmijën teksa po zgjidh problemin.
- ◆ Përgëzojeni për zgjidhjen e dhënë.

Në një situatë apo sjellje të papëlqyer, i rrituri duhet të ndalet e ta dëgjojë fëmijën. Situatën duhet ta shikojë me sytë e fëmijës për të kuptuar më mirë atë që ndien ai. Pranojini të qarat e fëmijës apo shpërthimet e inatit të tij. Pasi të qetësohet fëmija, i rrituri duhet të përmbledhë ngjarjen.

Ndonjëherë fëmijët mund të mërziten më tepër nga mënyra se si u është folur sesa nga ajo që u është thënë. Për këtë duhet t'i japim të drejtë fëmijës që mërzitet dhe më pas ta sqarojmë se ku ka qenë problemi. I rrituri mund të reagojë menjëherë, ndoshta edhe dhunshëm në një situatë grindjeje mes fëmijëve. Mirë është që, pasi të qetësohet, t'u kërkojë falje fëmijëve. Komunikim i mirë me fëmijën ndodh atëherë kur i rrituri i stimulon fëmijët të flasnin dhe të tregojnë jo vetëm për gjëra që i gëzojnë, por edhe të shprehin dëshira, të kërkojnë çfarë u pëlqen, të shprehin në lidhje me gjëra që nuk u pëlqejnë, që i mërzisin, që i shqetësojnë apo i frikësojnë.

Shprehinë e komunikimit dhe të zgjidhjes së konfliktit

Gjatë lojës, por edhe në veprimtari të tjera gjatë ditës, fëmijët mund të ndeshen me situata konfliktuale, të cilat shpesh mund të degjenerojnë në shpërthim emocionesh negative. Ne duam që fëmijët të pasqyrojnë sjellje të mira dhe të minimizojnë shfaqjen e sjelljeve negative. Për këtë arsye na ndihmojnë shprehinë e komunikimit. Këto shprehësi u duhen mësuar fëmijëve hap pas hapi derisa ata t'i përdorin si veprime rutinë.

Cikli i zgjidhjes së një problemi kalon në 4 hapa

1. Të kuptuarit e problemit (*Cili është problemi? Çfarë e shqetëson fëmijën?*)
2. Dhënia e alternativave për zgjidhje (*Si mund të veprojmë për ta zgjidhur problemin?*)
3. Parashikimi i rezultatit të zgjidhjes (*Çfarë do të ndodhë nëse vepromë kështu? Po nëse nuk vepromë?*)
4. Zbatimi i zgjidhjes.

Disa nga teknikat që mund të përdorim në këtë cikël arsyetimi, janë:

- ◆ **Të dëgjuarit aktiv.** Dëgjimi i vëmendshëm për t'u njohur me nevojat, interesat e fëmijëve. Herë pas here i rrituri e ndalon fëmijën dhe përmbledh ato që është duke thënë ai. Kjo bëhet me qëllim që të dyja palët të kuptojnë të njëjtin mesazh.
- ◆ **Dhënia e alternativave.** Në një komunikim të mësuesit me fëmijën apo me të gjithë fëmijët ofrohen zgjidhjet e mundshme, ose mënyrat se si duhet vepruar në raste të tilla.

♦ **Zgjidhja praktike.** Përzgjedhja e alternativës më të mirë të mundshme për t'u realizuar. Në fund të fundit, çdo zgjidhje që do t'i jepet një situatë konfliktuale apo frenimit të një sjelljeje apo emocioni të padëshiruar bëhet që fëmija të bëjë atë për të cilën ka interes. Fëmijët parashkollorë "marrjen e hakut" apo bëjnë një veprim të dhunshëm e ndërmarrin për të arritur diçka që u përket, diçka që u është marrë padrejtësisht. Pra, që i ka lënduar, i ka mërzhitur apo i ka zemëruar. Ata nuk kanë si qëllim lëndimin e shokut apo nuk veprojnë me dëshirën për t'i bërë keq. Nëse vëzhgojmë sjelljen e mëtejshme të fëmijëve, vëmë re se ata për një kohë të shkurtër bëhen sërish shokë, duke harruar "zënkat" e mëparshme.

Kapitulli 11

Si t'i ndihmojmë fëmijët të fitojnë shprehitë për zgjidhjen e problemeve

Në jetën e përditshme fëmija ndodhet shpeshherë në dilema, për të cilat jo gjithmonë bëhen zgjidhjet e duhura.

Shprehitë e zgjidhjes së problemit fillojnë të fitohen që në moshë të hershme. Duke marrë shkas nga situatat e jetës së përditshme në vijim jepen 10 aktivitete nëpërmjet të cilave fëmijëve u prezantohet problemi, lihen të mendojnë për gjetjen e mënyrave të zgjidhjes dhe më tej të vendosin për zgjidhjen më të mirë.



Aktiviteti 1.

I rrituri cakton 2 fëmijë për të bërë një punë së bashku. Njëri nuk pranon, se do që ta bëjë vetë të gjithë detyrën. Tjetri është i shqetësuar për këtë fakt.

Problemi.

Çfarë duhet të bëjë fëmija i dytë?

Mendo.

Çfarë do të thotë kjo detyrë për të dy fëmijët? Cila do të ishte zgjidhja më e mirë për të kryer detyrën?

Tre këshilla

Alternativat e zgjidhjes

- ◆ Mos e lër vetëm shokun ta bëjë detyrën. Bëj gjysmën tënde dhe ai të bëjë të vetën.
- ◆ Pse shqetësohesh? Ai le ta bëjë vetëm.
- ◆ Pse nuk flet me të? Ai nuk i di të gjitha. Apo jo?

Pasojat

- ◆ Unë bëra gjysmën, ai gjysmën, por pjesët tona nuk u përputhën.
- ◆ Unë e lashë ta bënte vetë, por u ndjeva e padobishme.
- ◆ I dhashë disa sugjerime. Ai i pëlqeu dhe bëme një punë të shkëlqyer.

Aktiviteti 2.

Fëmija ka kursyer një sasi parash. Ato do t'i shpenzojë për veshje dhe lodra që kanë dalë së fundmi.

Problemi.

A mund t'i harxhoj kursimet e mia për veshjet, lodrat e fundit?

Mendo.

Cila do të ishte zgjidhja më e mirë?

Tre këshilla**Alternativat e zgjidhjes**

- ◆ Mos umerakos për paratë. Ato janë moda e fundit. Kështu që bliji. Do të dukesh "trendi".
- ◆ Mos u mërzi edhe po s'i bleve. Do të t'i harxhonin të gjitha paratë.
- ◆ Nëse do që t'i shpenzosh kursimet e tua në këtë mënyrë, është zgjedhja jote.

Pasojat

- ◆ Unë i bleva lodrat dhe veshjet e reja por dëshira ime zgjati vetëm 1 muaj. Tani mbeta pa para.
- ◆ Unë u mërzi që nuk i bleva lodrat. Tani ndihem keq. Nuk do të ta marr më mendimin për blerjet që do të bëj.
- ◆ Unë bleva vetëm 1 lodër, kështu që më mbetën para edhe për gjëra të tjera.

Aktiviteti 3.

Shokët kishin përgatitur një surprizë për mua. Unë e mora vesh rastësisht dhe nuk di si t'ia bëj.

Problemi.

Si duhet të sillem? A të bëj sikur nuk di gjë?

Mendo.

Ç'vlerë ka për ty surpriza që do të bënin shokët? - Empatia

Tre këshilla**Alternativat e zgjidhjes**

- ◆ Shko në festë dhe bëj sikur habitesh. Nëse do, në fund mund t'u tregosh se e kishe marrë vesh surprizën.
- ◆ Tregoju shokëve për surprizën. Në fund të fundit do t'u kursesh ca energji.
- ◆ Bëju ti një surprizë. Mos shko në festë.

Pasojat

- ◆ Unë nuk u tregova shokëve për surprizën. Ndoshta do të bëhem aktor i mirë se e luajta bukur pjesën. Shfaqja shkoi shumë mirë.
- ◆ Unë u tregova shokëve të vërtetën. Nuk u shtira. Shfaqja shkoi mirë, por ca shokë u mërzi që surpriza nuk funksionoi.
- ◆ Shfaqja u prish që nuk vajta unë. Edhe kur shkova vonë, prapë shokët nuk ishin në humor.

Aktiviteti 4.

Unë u vizitova dhe doktori më tha të vë syze. Jam i mërzi se një shok më tha "4 sysh" - (qorr)

Problemi.

Çfarë duhet t'i them atij?

Mendo.

Çfarë do t'ju bënte të ndiheshit mirë me veten tani që keni vënë syze?

Tre këshilla

Alternativat e zgjidhjes

◆ Qesh dhe thuaji: Hahaha edhe Alvin (personazh filmi për fëmijë) i ka syzet tamam si unë.

◆ Tregoji mesueses.

◆ Hidhi ndonjë gjë në pjatë kur të hajë drekë.

Pasojat

◆ Unë i thashë dhe u ndjeva mirë.

◆ Unë i tregova mesueses dhe ajo më tha se vësh syzet na ndihmojnë të shohim më mirë. Shokut do t'i them që syzet më duhen për të parë dhe për të nuk është problem, nëse unë mbaj syze.

◆ Jo, këtë nuk e bëj, se do të veproja njësoj si shoku.

Aktiviteti 5.

Unë ndjek serialin "X" që është për fëmijë më të rritur se unë.

Problemi.

A t'u tregoj shokëve/ shoqeve për të?

Mendo.

A është kjo diçka që vërtet nuk do ta ndaj me ta?

Tre këshilla

Alternativat e zgjidhjes

◆ Edhe unë e kam parë këtë film. Është i bukur, por jo për moshën tonë. Le ta mbajmë si sekretin tonë.

◆ Po pse do të merakosesh për atë që do të mendojnë shoqet? Tregojnë nëse do.

◆ Këtë film shikon ti?! Mos u tall. Vetëm të rriturit e shohin atë. Mos e shih më.

Pasojat

◆ Unë dhe shoqja ime u ulëm për ta parë serinë e radhës, biseduam pak për filmin pasi mbaroi, por nuk e vazhduam më diskutimin.

◆ Unë ua tregova shoqeve. Edhe ato e kishin parë. Kështu që të gjithë nisëm të diskutonim për filmin seri pas serie.

◆ Unë u ndjeva e turpëruar. Do të përpiqem të mos e marr vesh njeri. Unë nuk e shoh më atë film.

Aktiviteti 6.

Ema pëlqen filmin e ri të Uinksave, Klesta pëlqen filmin e ri të Barbit.

Problemi.

Ato duan mendimin tim se cila prej tyre ka të drejtë.



Mendo.

A mundet dikush t'u thotë ju se cila akullore është më e mirë?

Tre këshilla**Alternativat e zgjidhjes**

- ◆ Zgjidh Uinksat se janë personazhet më në modë tani.
- ◆ Zgjidh Barbin, ajo ka vite që është, por gjithmonë vjen me stile të reja.
- ◆ Pse duhet të jesh ti të zgjedhësh? Secila ka të veçantën e vet.

Pasojat

- ◆ Unë i thashë shoqeve që do të shoh filmin me Uinksa. Si rrjedhojë humba filmin me Barbin. Nga brenda kisha dëshirë, por meqë dhashë fjalën nuk vajta në kinema.
- ◆ Unë i thashë shoqeve që do të shoh filmin me Barbin. Si rrjedhojë humba filmin me Uinksat. Nga brenda kisha dëshirë, por meqë dhashë fjalën nuk vajta në kinema.
